



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 11 KORRIK 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 11. JULA 2013. GODINE**

**KORRIK - JUL  
2013**

### **Rendi i ditës**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për amnistinë.

### **Dnevni red**

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Amnestiji.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
Të nderuar zëvendëskryeministra,  
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

### **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Koha është e kufizuar në 30 minuta, diskutimi në emër të Grupit parlamentar zgjat 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!  
I nderuar Kabinet qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Para se ta adresoj shqetësimin të cilin e kam pasi që javë më parë përfundua vitin shkollor, fillimisht dua t'i uroj të gjithë nxënësit, prindërit dhe Ministrinë e Arsimit për përfundimin e një viti shkollor dhe nxënësve u uroj suksese të vazhdueshme edhe në të ardhmen.

Shqetësimi im sot ka të bëjë me peshën e çantave të fëmijëve tanë në shkolla, e cila nga viti në vit po mbingarkohet, po bëhet çdoherë e më e rëndë dhe kjo po paraqet një shqetësim për nxënësit, prindërit, arsimtarët dhe të gjithë ne.

Si pasojë e mbingarkesave të çantave të fëmijëve shkollorë të cikleve të ulëta po krijohen deformime të shtyllës kurrizore tek fëmijët, i njohur si problem shëndetësor i skoliozës idiopative. Devijimi i shtyllës kurrizore skolioza idiopatike ose e fituar përbën një problem shëndetësor shqetësues për fëmijët shkollorë, sepse sipas disa hulumtimeve të kryera në shkolla është konstatuar se rreth 40% e nxënësve kanë disbalancë muskulore, për shkak të qëndrimit, postuarës së keqe kanë devijime të shtyllës kurrizore, që paraqet një problem shqetësues për shëndetin e fëmijëve tanë.

Duke ditur se problemet e skoliozës nisin të shfaqen më së shpeshti në moshën 10-15-vjeçare, si prind, si deputet dhe si profesionist i kësaj fushe dua t'i sensibilizoj institucionet shtetërore, Ministrinë e Arsimit, drejtoritë komunale të arsimit, drejtoritë e shkollave, mësuesit, prindërit, për edukimin e fëmijëve, se ata të kujdesen për posturën e tyre në vazhdimësi për t'i shmangur problemet e shtyllës kurrizore gjatë rritjes, me qëllimin më të mirë, që të kemi fëmijë të arsimuar dhe të shëndetshëm.

Ministria e Arsimit bashkë me drejtoritë e shkollave dhe profesionistët shëndetësorë të kësaj fushe do të duhej të përpilonin një strategji t'i përbashkët për të parandaluar problemet e deformimeve të shtyllës kurrizore tek fëmijët, duke filluar së pari një kontroll

mbi peshën e çantave që ajo të revitohet dhe të jetë më e lehtë, duke u mundësuar nxënësve që një pjesë të librave shkollorë t'i lënë në raftet e klasave. Nuk besoj se është e nevojshme që të gjitha ato libra t'i bartin fëmijët me vete në shkollë.

Përveç kësaj, gjithsesi është i nevojshëm një bashkëpunim i profesionistëve shëndetësorë me prindër dhe arsimtarë për edukimin e fëmijëve, për t'i shmangur problemet e paraqitjes së skoliozës duke edukuar fëmijët për mënyrën e duhur të qëndruarit ulur apo në këmbë dhe bartjen e çantës shkollorë.

Sipas standardeve të përcaktuara nga Organizata Botërore e Shëndetit ngarkesa fizike tek fëmijët nuk guxon të kalojë 10%-shin e peshës trupore të fëmijët. Duke bërë ndërgjegjësimin për rëndësinë e zvogëlimit të peshës së çantës shkollorë dhe të qëndruarit si duhet, ne u kursejmë fëmijëve tanë dhembjet trupore dhe deformimet e shtyllës kurrizore në rritje, sepse skolioza sjell më vonë një serë ndryshimesh të tjera, që kanë të bëjnë me muskujt dhe me organet e brendshme të fëmijët.

Të nderuar kolegë deputetë,  
Kur këto probleme janë të paraqitura te fëmijët në...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Një grup i të rinjve që kanë ndjekur shkollën për media të reja- Programi i Institutit Kombëtar Demokratik, me vizitat që i kanë bërë Shpellës së Gadimës dhe takimet me ekspertë të ndryshëm, kanë vërtetuar gjendjen e vështirë, në të cilën momentalisht gjendet ajo.

Një dokument prej 10 faqesh i krijuar nga kjo iniciativë na është dërguar neve deputetëve të Parlamentit të Kosovës, duke shpresuar që ky raport i dalë nga shkatërrimet që po ndodhin në shpellë, të rezultojnë me ndërmarrje masash.

Iniciativa “Shpëto shpellën” e krijuar më 9 mars të këtij viti ka evidencuar problemet kryesore të cilat rrezikojnë ekzistencën e kësaj shpelle, sidomos në ndërtimin e rezervarit të ujit, nga punimet në gurore rreth shpellës, si dhe nga keqmenaxhimi për mirëmbajtjen e saj. Problemi qëndron tek vendosja e rezervarit në vend të papërshtatshëm.

Grupi i të rinjve, në bazë të konsultimeve me gjeologët ka konstatuar se me ndërtimin e rezervarit është ndryshuar niveli i nevojshëm i qarkullimit të ujit dhe është rritur pesha mbi shtyllat natyrore të shpellës, në të cilat qëndron ajo. Madhësia e rezervarit ka lënë të kuptohet se për ndërtimin e saj është përdorur makineri e rëndë. Mjetet kanë shkaktuar

shumë dridhje ndaj shkëmbinjve të shpellës e posaçërisht ndaj shtyllave të saj, të cilat sipas gjeologëve janë shumë të dëmshme.

Fillimi i funksionimit të saj do të ngarkojë edhe me tutje shpellën, meqë qarkullimi i ujit përmes pompave të rezervarit do të shkaktoje dridhje dhe zhurmë të vazhdueshme në të.

Problemet gjithashtu vazhdojnë edhe me ndriçimin e shpellës. Reflektorët krijojnë cynobakterie që në të ardhmen shndërrohen në myshqe, specie të ndryshme, duke përfshirë edhe lakuriqët, që janë simbol i shpellave, rrezikojnë ekzistimin e tyre në këto kushte.

Grupi ka marrë premtime edhe prej zëvendësministrit të Mjedisit, i cili ka premtuar ndryshime. Njëra ndër anëtarët e këtij grupi Fillojeta Konjuhi, anëtare pra e këtij grupi, thotë se ka ende gurrës që punojnë aktivisht afër Shpellës së Gadimes dhe se të gjitha të këqijat që po ndodhin rreth saj duhet të parandalohen nga organet shtetërore.

Ky ekip kërkon nga institucionet relevante mirëmbajtje me kujdes më të mirë ndaj shpellës, si zonë e mbrojtur nga shteti. Kërkojnë gjithashtu një studim fizibiliteti të gjendjes aktuale nëpërmjet krijimit të një ekipi me ekspertë ndërkombëtarë të fushës, zhvendosjen e të gjithë rezervarëve të ujit të ndërtuar mbi shpellë në një vend të përshtatshëm, që do të mundësonte qarkullimin e ujit në formë normale dhe sipas kushteve natyrore.

Dhe në fund, ata kërkojnë një trajtim të shpellës, që të bëhet me ligj të veçantë, sipas standardeve evropiane. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Teutë Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Edhe tema ime është e njëjtë sikurse kolegja nga LDK-ja, prandaj unë nuk do ta elaboroj më tepër, vetëm se i bëj thirrje Qeverisë që ta marrë shumë seriozisht mbrojtjen e shpellës.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Emilija Redžepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedniče!

Na sednici skupštine opštine Prizren održanom krajem juna 2007.godine usvojen je predlog odluke o privremenom regulacionom urbanističkom planu za Prevalac u nacionalnom parku Šar-planina u skladu sa uputstvom izdatom od strane Ministarstva sredine i prostornog planiranja.

Tadašnja vlada u saradnji sa skupštinom opštinom Prizren umesto da prepuste planskom uređenju nacionalnog parka, ne poštujuću zakonsku obavezu da uređenje turističkog naselja Prealac uradi i izradi po propisima, poštujući sve parametre ekološke, sanitarne, klimatske, demografske strukture, te umesto da zaštiti prostor te regije, odgovorne

opštinske strukture direktno ili indirektno učestvuju u degradiranju prostora i haotično i nekontrolisanoj izgradi objekata i pretvaranja Prevalca u nehigijensko naselje ruglo ljudskog i neljudskog uništavanja jednog od nacionalnog parka naše republike.

Umesto objekata od opštih društvenih koristi, kao što su odmarališta, kamp-kućice, staza za rekreaciju, skijaški centri, to je prostor koji predstavlja potencijalno izvoriste zaraze i epidemije ekološko zagađenje celog prostora župske regije.

Iz svega ovoga što sam iznela, osim lične koristi pojedinaca iz vlasti, proizilaze planski ili ne, da neko preko promene ekologije, želi promeniti nacionalnu strukturu gornjeg sela i ovog dela župe uopšte, upravo na teritoriji gde bi po svim zakonima sveta a pre svega Kosovskim trebalo je već da funkcioniše opština sa većinskim bošnjačkim življem u Rečanima.

Vreme je da se sa ovom problematikom ozbiljno pozabavi vlada i Skupština Kosova, koja je u obavezi da štiti svoje nacionalno blago, radi generacija koje dolaze. Bošnjačka zajednica župskog kraja Prizrenske opštine podržava odluku Ministarstva za prostorno planiranje gospodina Dardana Gašija i ohrabri ga da u tom procesu istraje do kraja, odnosno podrži odluku ministarstva o rušenju 90% bespravno sagrađenih objekata, kao i uzurpacije privatnih parcela meštana gornjeg sela od strane privatnih lica. Zahvaljujem se, predsedniče!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Amir Ahmeti.

AMIR AHMETI: I nderuar kryetar,  
Kabinet qeveritar,  
Kolegë deputetë,  
Qytetarë të Kosovës,  
Fillimisht më lejoni që t'ju uroj muajin e Ramazanit, muajin e adhurimit dhe solidaritetit.

Të qenit refugjat është e njohur shumë mirë për popullin tonë. Në fillim të shekullit të kaluar, gjatë luftërave ballkanike shumë kosovarë migruan në Turqi, Siri e Jordani. Gjithherë me mall dhe me shpresë për t'u rikthyer në vendlindje, ata mërgimtarë ruajtën gjuhën dhe traditën e tyre, por fatkeqësisht Kosova për 100 vjet nuk ishte e sigurt për kthimin e tyre.

Historia na u përsërit gjatë luftës së viteve '98 – 99, por fati i gjeneratës sonë ishte më pak i dhembshëm, sepse pas vuajtjeve erdhi shpresa dhe të gjithë refugjatët u kthyen në shtëpi.

Populli i Kosovës nuk do ta harrojë kurrë përkrahjen e shumë vendeve mike që ndihmuan dhe u përkujdesen për refugjatët tanë. Në shenjë solidarizimi refugjatët tanë u vizituan nga shumë personalitete të botës si udhëheqës shtetërorë, diplomatë dhe aktivistë të ndryshëm, ndër ta edhe mbretëresha e Jordanisë, Rania Abdullah. Ajo erdhi dhe u solidarizua me refugjatët e Kosovës që ishin strehuar përkohësisht në Maqedoni, por edhe solli ndihma të konsiderueshme.

Duke përkujtuar të kaluarën tonë si refugjatë, institucionet dhe populli ynë duhet të jenë gjithnjë solidarë me refugjatët kudo në botë e në këtë rast edhe me refugjatët e Sirisë, të cilët po gjejnë strehim të përkohshëm në Turqi, Jordani dhe vende të tjera. Aq më tepër, se në mesin e refugjatëve sirianë në Jordani është edhe një numër i vogël i shqiptarëve (arnautëve), që po u përsëritet historia e gjyshërve të tyre, siç e ceka në fillim e të cilët janë kryesisht nga trevat e Kosovës, nga Llapi e Karadaku, nga Drenica e Dukagjini dhe nga viset tjera.

Nga vizita e fundit, që kishim në Jordani, me kryetarin e Kuvendit, zotin Krasniqin dhe me deputetin zoti Isufi, përveç takimeve tjera ne u takuam edhe me arnautët e Jordanisë dhe refugjatë arnautë nga Siria, në krye me aktivistin e dëshmuar, doktor Muhamed Arnautin, i njohur besoj për të gjithë ne. Ata na njoftuan për gjendjen e diasporës shqiptare në Lindjen e Mesme, e sidomos për refugjatët arnautë të Sirisë në Jordani, të cilët po jetojnë në kushte shumë të rënda.

Me këtë rast, lus të gjithë juve, veçmas ministrin e Diasporës dhe atë të Punëve të Jashtme, që të merren masat e duhura, që ato pakë familje të arnautëve refugjatë në Jordani të kenë një përkujdesje nga shteti ynë dhe i tyre.

Tani që kanë filluar të aplikohet regjimi i vizave, Ministria e Punëve të Jashtme duhet të lehtësojë ardhjen e tyre tek të afërmit e tyre në Kosovës, të cilët kanë hapur dyer për ta, sikur për shembull familja e deputetit Deshishku, e cila ka hapur dyer për 2-3 familje të arnautëve, farefis të tyre këtu në Kosovë dhe po përkujdesen për ta.

Të gjithë ne i dimë mundësitë e Kosovës, por tani ata po presin mbështetjen tonë dhe së bashku të gjitha instancat shtetërore, por edhe organizatat bamirëse dhe popullata e Kosovës, të bëjnë një hap drejt tyre, që në këtë muaj të adhurimit dhe solidaritetit t'u dalim në ndihmë. Ju lus për mirëkuptim. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

**ALMA LAMA:** Faleminderit, zoti kryetar!

Çështja që dua të ngre sot unë, lidhet me një shkrim të botuar në gazetën “Zëri”, i cili flet për një situatë skandaloze të krijuar në Aeroportin e Prishtinës, ndërmjet kompanisë “Limak” dhe punëtorëve të saj.

Është një trajtim i punëtorëve në mënyrë krejtësisht jodinjitoze. Përdorimi i dhunës verbale apo fizike, siç ankohen punëtorët është krejtësisht e papranueshme, drejtorë që gjuajnë me shpuzore punëtorët. Kjo është skandaloze.

Limaku, kjo kompani turke, të cilës i është dhënë Aeroporti në menaxhim nga ana e Qeverisë së Kosovës, nuk po i përmbahet as kontratës, ku në vend që t'i përmirësojë shërbimet e Aeroportit, po i përkeqëson ato. Në fakt, kjo kompani turke ka bërë gjithçka për të larguar edhe disa kompani fluturimi prestigjioze evropiane përmes një konkurrence jo të drejtë.

Qeveria duhet të matet mirë kur u jep tenderë shumëmilionësh kompanive të huaja, të shohë se cilat janë këto kompani, si janë sjell ato në të shkuarën përveç ofertës dhe jo t'i shohë vetëm si një mundësi për të përfituar dhe për të mbushur xhepat e tyre.

Një trajtim skllavërues punëtorëve ua ka bërë edhe kompania tjetër turke “Bechtel&Enka”, e cila edhe pse ka marrë një tender prej një miliard eurosh nga Qeveria e Kosovës për autostradën, ku çmimet janë trefish më të larta se sa çmimet e tregut, i ka paguar punëtorët vetëm me 7 euro në ditë për një ditë pune prej 12 orësh.

I bëj thirrje Inspektoratit të Punës që të ndërmarrë kontrolle intensive, për të parë se si kompanitë private po i trajtojnë punëtorët, të cilat po sillen gjithnjë e më shumë me logjikën afrikane të trajtimit të punëtorëve, të shfrytëzimit të njerëzve.

Kjo është e papranueshme për një vend demokratik, kështu që përgjegjësia kryesore bie mbi Qeverinë e Kosovës. Duhet të jetë shumë më e vëmendshme për mënyrën se si po trajtohen njerëzit në këtë vend. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ditëve të fundit do të thotë dhjetëra qytetarë të Kosovës po kalojnë transit nëpër Serbi, duke synuar që të arrijnë në Hungari, për të ikur më pas drejt vendeve tjera të Evropës.

Kjo është një përpjekje e arsyeshme dhe e them e arsyeshme, pasi që kosovarët edhe më tutje mbesin qytetarët e vetëm në rajon, të cilët nuk mund të lëvizin lirshëm në Evropë. Mendoj se është përpjekje e arsyeshme dhe shumë humane, sepse këta qytetarë, mbi 70% e tyre të rinj duan më shumë vende pune dhe një jetë më të mirë.

E në anën tjetër, ajo që ne si shtet dhe si shoqëri po përpiqemi të bëjmë, është që sa më shpejt të mundësojmë që qytetarët e Kosovës të kenë mundësi të lëvizin, por me dokumentet e tyre legale.

Të njëjtën gjë po përpiqet ta bëjë edhe Bashkimi Evropian, por kjo kurrësi nuk arrihet përmes trafikimit me njerëz, ku përfitojnë strukturat e krimit të organizuar, ku rrezikohet në masë të madhe jeta e qytetarëve tanë e ku këtyre qytetarëve u merren shuma marramendëse parash dhe prapë ndalohen në kufij të ndryshëm. Dhe, në rastin e parë kthehen në Kosovë, siç është edhe rasti i sotëm, ku do të kthehen qytetarë të Kosovës nga Austria.

E njëjta gjë do të ndodh edhe me rreth 4 mijë kosovarë, që po mbahen në strehimore të Hungarisë. E përgjegjës për këtë shkelje të rëndë të drejtave të njeriut janë rjetet e trafikantëve, të cilët gjejnë korridore të rrezikshme dhe manipulojnë qytetarët e Kosovës, që po keqinformohen dhe po bien pre e keqinterpretimeve të tyre.



Besoj shumë, se institucionet do të informojnë saktë opinionin dhe se hetimet e nisura do të parandalojnë kontrabanduesit. Qytetarët e Kosovës nuk do ta harrojnë asnjëherë tragjedinë në lumin Tisa, në të cilin kishin pësuar 18 kosovarë derisa po kalonin me barkë përmes lumit Tisa, ndërmjet Serbisë e Hungarisë.

Dhe krejt në fund, si deputete e këtij Parlamenti ftoj shtetet anëtare të Bashkimit Evropian veç e veç që t'i kuptojnë sa më drejtë rrethanat e Kosovës. Gjenerata e re e Kosovës nuk do të jetë asnjëherë barrë për Bashkimin Evropian dhe sa më shpejtë të hapet rruga për rininë e Kosovës në vendet e BE-së, aq më shumë vendi ynë do të jetë kontribuues në vetë vlerat evropiane. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

**TEUTA SAHATQIJA:** Faleminderit, kryetar!

Edhe unë e kam temën e njëjtë, por unë mendoj që duhet një qasje pak më ndryshe ndaj kësaj teme, sepse 4 mijë kosovarë do të kthehen apo do të mbesin nëpër kampet e Hungarisë.

Ne dje dëgjuam mbajtjen e një takimi bashkërendues të iniciuar nga ministrja Vlora Çitaku, me ministrin e Punëve të Brendshme, me kryeprokurorin e shtetit, drejtorin e Policisë dhe udhëheqësin e Divizionit Ekzekutiv të EULEX-it. Ata u morën vesh që t'i bashkërendojnë veprimet për krimin e qytetarëve nga kampet e Hungarisë në Kosovë dhe pengimin e qytetarëve tjerë që t'ia mësyjnë Evropës me shpresë që do të kenë sukses për t'u arratisur.

Po, përveç trafikantëve që pasurohen nga fatkeqësia e këtyre njerëzve, të cilët janë njerëz të ndershëm, njerëz familjarë, të cilët zori i madh i ka qitur në rrugë. Në të kaluarën kishim zor nga ndjekja, vrasja e të rinjve tanë, që shkonin ushtarë nëpër kazemat e Serbisë dhe iknin nga dhuna e armiqve, që donin të na shfarosnin.

Sot Kosova është e pavarur, me institucione të zgjedhura, të ndihmuara nga trafikantët e votave, sot qytetarët nuk ikin nga ushtria e dhuna e policisë, sot nga Kosova e pavarur ikin për të siguruar kafshatën e gojës për vete dhe për familje. Kur për një vend pune 300 veta konkurrojnë e në Gjakovë deri në 1 mijë veta konkurrojnë, atëherë shihet që këtu nuk është vend ku mund të rrinë, përkundër dëshirës.

Në Kosovë çdo vit 30 mijë të rinj dalin në tregun e punës, ndërsa politika qeveritare deri më tani kanë arritur të sigurojnë vetëm 7 mijë vende pune në vit, kryesisht në administratën shtetërore dhe në ndërmarrjet publike. Dhe, kryeministri çdo vit premtim rritjen e rrogave të punësuarve që është gjë e mirë, por deri më tani nuk arriti ta rrisë numrin e të punësuarve.

Kryeministri premtim të hapë universitete në çdo komunë, por përveç që po blen kohë për tri vjet të studimeve, nuk po arrin të sigurojë punë për këta studentë të diplomuar nesër.

Dhe, nëpër rrugët e Evropës enden si të diplomuarit nëpër fakultete ashtu edhe të padiplomuarit, që ikën ilegalisht dhe rrezikojnë shëndetin dhe jetën. Dhe, ikja e qytetarëve tanë nuk ndalet me polici dhe me EULEX-in, por me qeverisje e cila ka prioritet zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të punës nëpër kompani private, jo institucione qeveritare, me luftimin e korrupsionit, luftë e cila do të sjellë kompani prestigjioze në Kosovë dhe do të hapë vende pune të qëndrueshme.

Me luftimin e korrupsionit dhe përdorimi i këtyre parave të korrupsionit për krijimin e vendeve të punës për qytetarët tanë që sot po ikin e po e lënë shëndetin edhe jetën nëpër lumenjtë dhe kampet e Hungarisë e të Evropës.

Por, kjo Qeveri dhe kryeministër nuk ka ide si bëhet krijimi i vendeve të qëndrueshme të punës, përndryshe deri tash do ta bënte. Prandaj, zonja Çitaku, angazhimi i saj për kthimin e qytetarëve dhe pengimin e trafikantëve, ndonëse duket i singërtë, nuk mund...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Shërbimet inteligjente me koncept okupes të Beogradit po humbin luftën në Republikën e Kosovës, të cilën e kanë luftuar që në embrion dhe gjatë gjithë rritjes së saj.

Kjo epërsi nuk ka mundur të ndodhë pa mbështetjen e miqve tanë të mirënjohur. Asnjë nga institutet prestigjioze të juristëve në Kosovë nuk ka interpretim të tillë çfarë i bën një subjekt politik Projektligjit për amnistinë. Asnjë nga juristët me integritet nuk i ka bërë interpretim të tillë çfarë po i bën një subjekt politik këtij projektligji, asnjë nga institutet prestigjioze të juristëve në Shqipëri nuk i ka bërë një interpretim të tillë çfarë po i bën një subjekt politik këtu në Prishtinë, madje, as edhe një personalitet me integritet shkencor në Prishtinë, Shkup apo në Tiranë nuk ka dalë me një interpretim të tillë, çfarë po i bën një subjekt politik këtij Projektligji në skenën politike duke terrorizuar e duke tejkaluar dhe të gjithë kufijtë e lejuar demokratikë, për arritjen e një qëllimi sado politik.

Asnjë nga subjektet serioze politike këtu në Kosovë apo në hapësirat tjera shqiptare jashtë Kosovës nuk ka dalë me ndonjë qëndrim në përkrahje të këtij subjekti, për ta kundërshtuar këtë projektligj. I vetëm ky subjekt i quajtur Lëvizje, lëvizë njerëz të vullnetit të mirë, u bën thirrje qytetarëve të brengosur për fatet e vendit, t'i sulmojnë institucionet dhe përfaqësuesit e tyre, duke i motivuar e nxitur për anarki, në një fazë të rëndësishme të zhvillimit të këtij vendi dhe për forcimin e integritetit të Republikës së Kosovës. Në përkrahje të këtij projektligji janë rreshtuar të gjithë subjektet politike të përgjegjshme të këtij vendi dhe shtetet mike të dëshmuara për miqësi.

Ky subjekt i jep vetit të drejtë të thërrasë simpatizuesit hapur për anarki dhe sulm mbi institucionet e vendit dhe mbi përfaqësuesit e qytetarëve të Republikës së Kosovës, pa i

kursyer as përfaqësuesit diplomatikë, të cilët nuk janë këtu vetëm për të vëzhguar zhvillimet politike, por para së gjithash janë dërguar këtu për t'i mbështetur e ndihmuar institucionet tona në forcimin e integritetit dhe për të mirën e qytetarëve tanë, mbi parimet që kanë ndërtuar shtetet e tyre.

Ne si institucione tona do të shkelnim ato parime të shteteve të tyre, sidomos në fushën e ligjeve, për asnjë çmim nuk do të na toleronin dhe më pak do të na përkrahnin. Nëse ky subjekt politik ka vendosur të bëjë ndikim politik me mjete parlamentare, duke qenë e përfaqësuar në këtë Kuvend, gjithë idetë, çdo koncept politik, çdo nismë dhe çdo zhvillim politik e legjislativ mund ta kundërshtojë përmes përfaqësuesve të vet në këtë Parlament edhe pse edhe këtu nuk janë në dinjitetin e të zgjedhurit dhe nuk kultivojnë gjuhën parlamentare, duke përdorur gjuhë e gjeste të pa dinjitet, të padenja për veten dhe për institucionin tonë, me nivelin e emancipimit tonë të përgjithshëm dhe kundër vullnetit të shumicës jashtë dhe brenda këtij Parlamenti.

Nëse skenaristi me adresë në Beograd, sidomos që nga viti 2004 deri sot, në këto aksione ka nxitur turma me motive të mundshme nëpër kohë kundër institucioneve tona, duke përdorur e shfrytëzuar njerëz me kredenciale të respektuara për opinionin tonë, në aksionet e fundit për të kundërshtuar këtë projektligj në ballë ka nxjerrë protagonistë nga kontingjenti...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar! Flas në emër të Grupit.

Unë sot do e ngre çështjen e korrupsionit, çështje e cila është përditshmëri e aktiviteteve të kësaj Qeverie. Kosova pas më shumë se pesë vjetëve të pavarësisë së saj karakterizohet me korrupsion, krim ekonomik dhe nepotizëm, dukuri këto të cilat po e dëmtojnë rënd imazhin e qytetarëve të Kosovës dhe imazhin e republikës së re.

Se në çfarë gjendje jemi sa i përket korrupsionit, kjo konfirmohet nga raporti i fundit i organizatës Transparency International, ku thuhet se më shumë se gjysma e kosovarëve mendojnë se korrupsioni është në rritje në dy vjetët e fundit. Me vetë faktin se jo vetëm në dy vjetët e fundit, por në pesë vjetët e fundit kemi aq shumë vepra korruptive të konfirmuara dhe nga ana tjetër nuk kemi asnjë ndëshkim, nuk kemi asnjë person që ka marrë dënimin e merituar, qytetarët e Kosovës nuk ka se si të mendojnë ndryshe.

Konfirmimi i kësaj gjendjeje nga një organizatë kredibile do të duhej të alarmonte Qeverinë, por në fakt po ndodh e kundërta. Raportet e tilla kritikuese po injorohen nga përfaqësues të Qeverisë në atë masë, sa po mundohen të vënë në pikëpyetje kredibilitetin e këtyre institucioneve, gjë e cila po na turpëron tutje.

LDK-ja është shumë e shqetësuar me dëmin që kjo qeveri po i bën vendit. Keqpërdorimet e taksave të qytetarëve, nepotizmi e krimi ekonomik kanë kontribuar në gjendjen, në të cilën sot janë katandisur qytetarët e Kosovës, ku gjysma prej të cilëve jetojnë në varfëri.

Mungesa e rendit dhe ligjit, përdorimi i standardeve të dyfishta nga ana e institucioneve për qytetarët e Kosovës po e zbeh edhe më tepër imazhin e Kosovës dhe është reflektuar dukshëm në tkurrjen e investimeve të huaja direkte, aq të nevojshme për zhvillimin e vendit të ri. Se sa korrupsion ka në Kosovë, askush nuk e vë në dyshim këtë, ai ndodh çdo ditë para syve tanë, ai lejohet të ndodhë nga institucionet dhe organizohet nga vetë ato. Në shumë raste nepotizmi dhe korrupsioni kryhet nga institucionet që janë të thirrura për ta luftuar atë.

Për më tepër, korrupsioni nuk luftohet me fjalë dhe deklarata, korrupsioni luftohet me vepra duke u treguar vendin të gjithë të korruptuarve. Në Kosovë fatkeqësia më e madhe është mungesa e rendit dhe e ligjit. Fatkeqësia tjetër është se të korruptuarit janë të paprekshëm, janë mbi ligjin. Ne kemi plot institucione të cilat janë të thirrura ta luftojnë korrupsionin, por asnjëra prej tyre nuk po e kryen punën e tyre.

Sa herë që ne flasim për korrupsionin arsyetimi nga ana e Qeverisë është se ky na qenka perceptcion për korrupsionin dhe matjet nuk janë të sakta.

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Perceptimi është përafrim i realitetit dhe krijohet pikërisht në bazë të asaj se çka ne shohim çdo ditë. Qytetarët sapo hapin televizorin nuk dëgjojnë asgjë tepër, të gjitha lajmet hapen me afera korruptive dhe normalisht se nuk ka se si të krijohet një perceptim ndryshe. Gjysma e tyre paguajnë ryshfete për të marrë shërbimet që institucionet e këtij vendi duhet t'i kryejnë për ta. Ata paguajnë taksa dhe taksat e tyre shkojnë në xhepat e qeveritarëve tanë. Dhe, kjo gjendje është e padurueshme dhe qytetarët gjithashtu ne anketën e organizuar nga Transparency International kanë bërë me dije, që durimi i tyre po shterret dhe një ditë ata do të bëjnë grushtshtet dhe le të shpresojmë që kjo të ndodhë sa më shpejtë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Kemi tri pyetje parlamentare, por ministrat nuk janë këtu. Megjithatë le të vendosin deputetët, i lexojnë apo s'i lexojnë pyetjet.

Deputeti Halit Krasniqi, pyetje për ministrin Blerand Stavileci. Deputeti s'është këtu.

Deputetja Albana Fetoshi, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. A doni ta parashtroni pyetjen? Fjala deputetes Albana Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryetar!

Pyetja ime ka të bëjë me 53 punëtorë të Kompanisë “Marketingu”, të cilët u larguan dhunshëm nga objektet e tyre në vitet e ‘90-ta. Fatkeqësisht, ata ende vazhdojnë të mos jenë në ato objekte, për shkak se një kohë u shfrytëzuan nga misioni i OSBE-së. Për më tepër, ky mision i paguante qiranë ndërmarrjeve të Serbisë, mirëpo problemi i këtyre punëtorëve nuk u zgjidh ende, për shkak se në ato objekte tani janë të vendosura Prokuroria dhe KQZ-ja. Pra, në mënyrë të paligjshme iu dhanë Qeverisë së Kosovës.

Pyetja për zotin Hajredin Kuçi është - pse hapësirat e uzurpuara në mënyrë të paligjshme nuk po u kthehen punëtorëve të Kompanisë “Marketingu”? Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Liburn Aliu, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. A doni ta bëni pyetjen, deputet? Regjia, fjalën deputetit Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Meqenëse nuk është ministri, atëherë po e lëmë pyetjen për herën tjetër, përndryshe, pyetja kishte të bënte me shpërblimin jubilar për pensionistët, gjë që nuk po zbatohet në shumë vende.

KRYETARI: Pyetjet e deputetëve, që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit, neni 45, paragrafi 11 i Rregullores së Kuvendit.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës. Të pranishëm janë 73 deputetë.

### **3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mbajtura më 27 qershor 2013 dhe më 4 korrik 2013**

Pyes nëse keni vërejtje në këto procesverbale? Nuk ka.

Konstatohet se Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 27 qershor 2013 dhe 4 korrik 2013.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës,

### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për amnisti**

Para se të fillojmë me shqyrtimin e kësaj pike, ju njoftoj se për shqyrtimin e parë të Projektligjit për amnisti nuk është plotësuar afati dyjavor për pesë ditë pune nga data e shpërndarjes së paraparë me nenin 56 të Rregullores së Kuvendit. Andaj, për shqyrtimin e parë të këtij projektligji kërkohet nga Kuvendi që të miratojë shmangien nga Rregullorja.

Në bazë të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit, për t’iu shmangur Rregullores, Kuvendi vendos me 2/3-at e deputetëve të pranishëm në mbledhjen plenare.

Prania është 73 deputetë. Prania fizike 78, prania elektronike 101. Lus deputetët që të votojnë për prani. Votojmë tash

81 deputetë janë të pranishëm. Kërkohet 2/3-at e deputetëve të pranishëm për shmangie.

Ka mjaft deputetë për të votuar për shmangie. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 79 vota për, 13 kundër, 1 abstenim, kalon, do të thotë, ligji hyn në shqyrtim.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Propozuesi i ligjit, i nderuar kryetar, pastaj unë.

KRYETARI: Më falni pra, e ka fjalën propozuesi i ligjit, Hajredin Kuçi, zëvendëskryeministër.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që para jush të prezantoj Projektligjin për amnisti.

Natyrisht që diskutimi im i sotëm do të jetë i shkurtër dhe besoj se ajo që e kam diskutuar javën e kaluar është pjesë e atij mendimit tim, që unë e mbaj edhe sot e kësaj dite.

Por, ajo çka dua të them, ku ndryshojnë rrethanat, natyrisht që do të ndryshojë edhe ambienti dhe unë besoj, që do ta respektoj atë që ka ndryshuar.

Unë nisem nga një bindje jashtëzakonisht filozofike që shpeshherë e përdor vet dhe them për drejtësinë:” kur një ligj nuk i bie tamam një populli, duhet të ndryshohet ligji dhe jo populli”. Dhe, në këtë drejtim është parë që ligji i kaluar nuk i ka rënë tamam Kuvendit të Republikës së Kosovës, një pjese të shoqërisë civile dhe një pjese të subjekteve dhe individëve të tjerë dhe unë mendoj që ligji sot është i ndryshuar.

Është fat i madh që jetojmë në një vend demokratik ku pushtetet janë të ndara dhe Qeveria paraqet vetëm sponsoruesin e ligjit, ndërsa ju të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, jeni ata që e miratoni edhe këtë ligj.

Jam shumë i lumtur që ky vend ka shprehur besimin e vet përmbi të gjitha atë të popullit të Kosovës që të nxjerrë ligje sa më të mira që është e mundur dhe po ashtu jam shumë i bindur që Kuvendi i Republikës së Kosovës edhe në këtë rast, si në rastet tjera, do të nxjerrë ligjet më të mira të mundura që unë konsideroj se duhet t’i kenë tri kritere. E para të respektojë vullnetin e qytetarëve të Republikës sonë, e dyta t’i respektojë standardet më të larta ndërkombëtare dhe e treta t’i bie tamam apo të jetë funksional për vendin tonë.

Natyrisht e gjithë kjo ka për qëllim që t'u mundësojë njerëzve që të jetojnë të lirë, që të jetojnë në përputhje me perceptimet e tyre, po edhe të planifikojnë të ardhmen e tyre të lirë, por dhe të familjeve të tyre.

Besoj se në cilindo rast edhe në këtë rast, deputetë të nderuar, si përfaqësues të qytetarëve të Republikës sonë, do t'i respektoni këto kritere të theksuara.

Jam shumë i bindur, më shumë i bindur se sa ditën kur e kemi propozuar që ligjit të miratohet me 2/3 e Kuvendit të Kosovës, që ka pasur nevojë për një votim të tillë dhe jo me 51% apo në rastin tjetër ligji me herën e kaluar do të kalonte me 70 vota, por nuk do të arrinte konsensusin e mjaftueshëm apo të domosdoshëm i cili është i nevojshëm në raste të tilla.

Andaj sot besoj se kemi një konsensus më të gjerë, më demokratik dhe gjithsesi më të pranueshëm për shumicën e qytetarëve të vendit tonë.

Jam mirëkuptues për të gjithë ata që kanë luftuar për ligjin herën e kaluar, jam mirëkuptues për ata të cilët kanë pasur arsye tjera, jo politike që kanë votuar kundër dhe natyrisht do ta respektoj çdo vendim të Kuvendit të Republikës.

Më lejoni krejt në fund të them se në shtetet e konsoliduara ligji vjen si rezultat i një mentaliteti dhe realiteti të shprehur përmes vullnetit të qytetarëve, për demokraci të brishta, çfarë është ende e jona, natyrisht që ligji tenton t'i ndryshojë realitetet.

Unë jam i bindur se ky ligj do të bëjë një gjë të tillë. Ju ftoj që ta miratoni dhe ju faleminderit për vëmendje!

**KRYETARI:** Tani është fjala për kryetarin e Komisionit Funkcional për Legjislacion dhe Gjyqësi, deputetin Arben Gashi.

**ARBEN GASHI:** I nderuar kryetar i Parlamentit,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjin për amnisti dhe duke marrë parasysh që është ligj i ri, Komisioni për Legjislacion kërkon nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që ta përkrahin dhe të kalojnë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Radha është e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Behar Selimi.

**BEHAR SELIMI:** Faleminderit, zoti kryetar!  
I nderuar kryeministër,  
Kabinet qeveritar,  
Të nderuar deputetë,  
Vullneti i përgjithshëm politik i Partisë Demokratike, përkatësisht Grupit Parlamentar është pro këtij ligji, të bindur se përmes aprovimit të këtij ligji ne po krijojmë mundësinë e zhbërjes së strukturave ilegale apo paralele kudo që ndodhen ato, si në veri si në jug,

dhe në emër të integritetit të atyre që akoma s'janë integruar, sot e kemi edhe më lehtë të votojmë për arsyen e thjeshtë se projektligji tani e ka karakterin e qartë politik, ndonëse është akt juridik. Për më tepër kemi arritur edhe konsensus që të hiqet neni i shumëpërfolur 3, i cili ka pasur qëllim të humanizimit më shumë dhe të shmangies së karakterit politik apo të baraspeshës përmes karakterit human dhe atij politik, megjithatë për t'u arritur konsensusi ai u hoq.

Gjithashtu e vlerësojmë faktin se u qartësua se neni aktual 3, që ishte dikur 5 e bën ndarjen e qartë mes strukturave kriminale dhe atyre ilegale, prandaj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka vullnetin e përgjithshëm politik që ta mbështesë aprovimin e këtij ligji përmes të cilit hapet mundësia, po përsëris e zhbërjes, e zhdukjes, e shuarjes, të gjitha strukturave ilegale kudo që janë ato. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike fjalën e ka kërkuar deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Është e ditur se Grupi Parlamentar i LDK-së javën e kaluar kur u shqyrtua projektligji mbi amnistinë, në parim e ka përkrahur dhe ka qenë për aprovimin e tij, duke kushtëzuar votën e anëtarëve të vet me amendamente dhe ndryshime të caktuara të tij.

Po ashtu edhe sot Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah aprovimin e draftligjit mbi amnistinë, ndër të tjera edhe për këto arsye.

1. Së pari, për shkak se ky projektligj është paraparë si njëri prej veprimeve që duhet ndërmarrë sipas planit për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e cila marrëveshje është ratifikuar përmes Ligjit mbi ratifikimin e marrëveshjes i cili dy javë më parë është aprovuar nga ana e po këtij Kuvendi.

2. Arsyeja e dytë është ndryshimi i draftligjit mbi amnistinë konform kërkesës së Grupit tonë parlamentar. Duhet theksuar se versionin e parë të këtij draftligji që është shqyrtuar javën e kaluar ka përmbajtur nenin 3, në të cilin taksativisht janë numëruar afër 50 vepra penale, kryerësit e të cilave do të amnistoheshin.

Duke pasur parasysh se një numër i madh i këtyre veprave penale kryhen me përdorimin e dhunës siç janë shtrëngimi, vrasja, sulmi e tjera, ose cenojnë pasuritë, të drejtat dhe liritë e qytetarëve, siç janë vjedhja, kontraktimi, përfitimi jo proporcional pasuror e tjera, ne si Grup parlamentar kemi kërkuar që ky nen të fshihet në tërësi.

Qeveria me rastin e përpilimit të versionit të dytë, pra këtij që ne e shqyrtojmë sot, ka përfillur kërkesën tonë duke fshirë nenin 3 në tërësi, gjë që është edhe arsyeja e dytë për aprovimin e këtij drafti.



3. Arsyeja e tretë qëndron në faktin se pas publikimit të versionit të parë të draftligjit mbi amnistinë, u debatua për të shumë në qarqe të ndryshme, si politike ashtu edhe joqeveritare nga personalitete dhe ekspertë të ndryshëm.

Si pasojë e debateve të tilla ishte krijimi i perceptimit të gjerë se me këtë draftligj do të amnistohen kryerësit e veprave penale të vrasjeve, përfshirë edhe vrasjet e zyrtarëve dhe aktivistëve politikë.

Andaj, Grupi ynë Parlamentar me qëllim që t'i garantojë të gjithë qytetarët e Kosovës, familjarët e viktimave të vrasjes si dhe familjarët e aktivistëve dhe zyrtarëve të vrarë të LDK-së, kërkoi që versionit të parë të këtij draftligji t'i shtohet një paragraf apo një dispozitë në të cilën decidivisht do të theksohet se nuk do të amnistohen kryerësit e veprave penale kundër jetës dhe trupit.

Qeveria e Kosovës në ndërkohë ka aprovuar edhe këtë kërkesë të Grupit tonë parlamentar ashtu që në paragrafin 1.3 të nenit 4 të draftligjit që sot jemi duke e shqyrtuar ka inkorporuar këtë dispozitë, citoj:

“Amnistia nga cilado vepër penale e përmendur në këtë ligj nuk do të aplikohet për veprat penale që kanë rezultuar me lëndim të rëndë trupor ose me vdekje.”

Pikërisht kjo dispozitë e këtij ligji u garanton të gjithë familjeve të vrarëve, por edhe të gjithë kosovarëve se me këtë ligj nuk do të amnistohet asnjë vrasës, pavarësisht përkatësisë së tij etnike, moshës, kohës së kryerjes, vendit të kryerjes apo viktimës së tij.

4. Dhe së katërti, Grupi ynë ka kërkuar që me amnisti të mos përfshihen personat të afërt me Qeverinë dhe zyrtarë tjerë publikë të cilët janë pasuruar duke kryer vepra penale të keqpërdorimeve të autorizimeve në ekonomi dhe të veprave tjera të ngjashme kundër eunomisë dhe pasurisë së vendit tonë.

Duhet thënë se versioni i ligjit të cilin e kemi sot në shqyrtim në nenin 3 në të cilin trajtohen kushtet për amnisti, ndër të tjera si kusht për amnistimin e kryerësve të veprave penale kundër ekonomisë, kundër zgjedhjeve, rrezikimit të trafikut publik e tjera, kërkohet, po citoj: “Që vepra penale të jetë kryer me qëllim të kryerjes së veprës penale për rezistencë”.

Interpretimi ligjor i kësaj dispozite garanton se nga amnistia nuk do të përfitojnë personat të cilët duke vepruar si zyrtarë publikë dhe shërbyes civilë të vendit tonë e që e kanë dëmtuar ekonominë e Kosovës dhe janë pasuruar për një kohë të shkurtër, andaj duke pasur parasysh arsyet e lart theksuara si dhe zhvillimet e përgjithshme juridike dhe politike në vend dhe regjion, Grupi Parlamentar i LDK-së ka vendosur që votën e vet ta japë për aprovimin e këtij draftligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht me duhet të them që asnjëri nga kriteret që i përmendi zoti Kuçi, ky projektligj nuk i plotëson. Pra as nuk është në përputhje me interesat e qytetarëve pasi që këtë projektligj përditë po e kundërshtojnë qytetarët tanë dhe shoqëria civile, po edhe deputetët. Gjithashtu është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe kriteri i tretë, thatë që projektligji duhet t'i bie tamam një populli.

Unë, zëvendëskryeministër, nuk e di se me çfarë parametra jeni duke e matur këtë projektligj.

Është jashtë çdo praktike parlamentare dhe aspak demokratike, madje edhe precedent tejet i rrezikshëm që kjo Qeveri ende pa kaluar 24 orë, procedoi në Kuvend projektligjin të cilin nuk e votoi ky Kuvend ose më mirë për të thënë deputetët e ndërgjegjshëm të këtij Kuvendi.

Edhe me këtë projektligj, sikurse edhe me atë të kaluarin, u shpërfillën të gjitha procedurat e parapara me Rregulloren e Kuvendit, vetëm e vetëm për t'u ndier më mirë Daçiqi.

Pra i gjithë ky Kuvend po vepron në bazë të agjendave të Serbisë dhe Daçiqit e kjo është për të ardhur keq, të nderuar deputetë.

Me heqjen e nenit 3 nga projektligji i mëparshëm asgjë nuk ka ndryshuar substancialisht. Pra me heqjen e atij neni Qeveria bëri sikur e ndërroi ligjin, duke tentuar kështu që t'u hedh hi syve qytetarëve, shoqërisë civile, por edhe deputetëve të këtij Kuvendi.

Pra neni 3 i projektligjit aktual, kështu siç na është sjell ka për qëllim amnistimin e krimit, amnistimin e gjithë atyre kriminelëve serbë në veri dhe i njëjti ka për qëllim amnistimin krimit të organizuar dhe kontrabandës.

Nëse analizohen ligjet e amnistisë në vendet e ndryshme, mund të shohim se amnistimi konsiston në zvogëlimin e dënimit kryesor të personave që janë duke e vuajtur dënimin, duke i përjashtuar zakonisht recidivistët.

Në praktikën e vendeve të ndryshme bëhet përjashtimi vetëm i disa veprave penale të cilat përfshijnë kryerjen e veprave penale në grup, që zakonisht janë të natyrës së krimit të organizuar.

Përndryshe, këto ligje amnistojnë vetëm personat që janë duke e vuajtur dënimin, pra dënimi i cili ka marrë formë ekzekutive.

Në këto praktika asnjëherë nuk përfshihet amnistimi i personave ndaj të cilëve është nisur procedura e ndjekjes penale.

Rastet kur amnistohen personat nga ndjekja penale në rastet më eklatante, personave ndaj të cilëve ende nuk ka nisur procedura hetimore në praktikë janë raste të konflikteve të armatosura!

Zakonisht ky lloj i amnistisë bëhet si pasojë e gjendjes së jashtëzakonshme brenda territorit shtetëror, ku pushteti e njeh këtë situatë.

Pra për këtë edhe shërben shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme, sepse duke e shpallur gjendjen e jashtëzakonshme krijohet baza faktike për krijimin e një gjendje të veçantë juridike.

Kjo nënkupton që me ligj të veçantë mund të amnistohet grup i caktuar i personave që kanë vepruar brenda territorit të caktuar dhe në kohë të caktuar.

Kjo do të eliminonte diskriminimin e mundshëm që do të mund t'i bëhej personave të tjerë.

Mirëpo, Kosova asnjëherë më parë nuk e ka shpallur një gjendje të jashtëzakonshme, në pjesë të caktuar të territorit e as që e ka njohur një konflikt i cili ka pamundësuar ndjekjen penale të personave që kanë qenë ndesh me ligjin.

Kosova është shtirur gjatë gjithë këtyre viteve sikur asgjë nuk ka ndodhur dhe formalisht ka konsideruar se e ka shtri sovranitetin dhe rendin juridik në tërë territorin e Kosovës.

Pra, ky projektligj përveç se po amnistion krimet që janë kryer ndaj shtetit të Kosovës dhe rendit kushtetues të saj, po i amnistion edhe krimet ndaj ekonomisë së Kosovës, ndaj pronës publike e private në Kosovë, pra po amnistion kontrabandën, evazionin fiskal, tregtinë e kundërligjshme. Pra i njëjti shkon edhe në dëm të gjithë prodhuesve e bizneseve në Kosovë, pra shkon në dëm të fitimit të munguar të tyre për shkak të kontrabandës dhe mafisë.

Mos përcaktimi kohor i këtij ligji është shqetësim tjetër, pra nuk dihet se nga cili vit apo cila datë fillon të vlejë i njëjti, pra kjo nënkupton që do të amnistohen edhe kriminelët që shkaktuan dëmet e luftës.

Pra po amnistohen kriminelët e 12 000 të vrarëve, 3 000 të kidnapuarve, 20 000 grave të dhunuara, 120 000 shtëpive të shkatërruara.

Një tendencë tjetër që duhet pasur parasysh është fshirja nga evidenca penale e personave që janë në ndjekje apo në vuajtje të plotë të dënimit.

Sipas nenit 8, paragrafit 3 të projektligjit, është paraparë se brenda 60 ditëve nga hyrja e këtij ligji në fuqi të gjitha dënimet e formës së prerë do të fshihen sipas ligjeve në fuqi.

Pra, qeveria tenton që me miratimin e këtij projektligji t'i transformojë këta kriminelë në qytetarë të rëndomtë, pa asnjë gjurmë të kaluarës së tyre penale. Kjo ngase sipas nenit 102 të Kodit Penal, fshirja nga evidencat penale ka efektin juridik i cili i jep status personit të tillë sikur mos të kishte kryer asnjëherë vepër penale. Pra, ashtu sikur edhe Marrëveshja e dëmshme Thaçi - Daçiq, edhe ky projektligj përveç se i dëmshëm është edhe antikushtetues për shkak të përmbajtjes së tij. Pra, janë gjithsej 26 vepra penale që dëmtojnë interesat subjektive të qytetarëve të Kosovës e që me amnisti u mohohet e

drejta për mjete të efektshme juridike, e që në këtë rast është shkelje kushtetuese, përkatësisht neni 31 dhe 32 i Kushtetutës, ngase me këtë amnistim personave të dëmtuar nga veprat penale që janë përfshirë në këtë projektligj u mohohet e drejta për të propozuar ndjekjen penale. Gjithashtu kjo është edhe shkelje e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me nenin 13 dhe 14.

Përfundimisht ky projektligj dhe forma e imponuar e miratimit të tij, pra dy leximet brenda një dite, tregon qartë se është, përveç se i dëmshëm, i pandryshueshëm dhe si rrjedhim i papërmirësueshëm.

Prandaj, e vetmja rrugë e pengimit të amnistimit të krimit është vota kundër këtij projektligji, andaj u bëj thirrje të gjithë deputetëve të Kuvendit që mos ta votoni këtë projektligj.

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Në seancën e kaluar në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës pata kërkuar që projektligji për amnisti t'i ketë tri elemente të cilat nuk i kishte, shumë pastër, tepër të pastra.

Çështja e parë ishte që vrasjet dhe lëndimet e rënda trupore të mos amnistohen. Dhe projektligji që e kemi e përmban një provizion të tillë dhe unë nuk e di qysh po mund të thotë dikush po amnistohen vrasësit kur ka provizion tepër të qartë, se vrasjet dhe lëndimet e rënda trupore nuk do të amnistohen. Gjithçka që ka rezultuar, çdo vepër penale që ka rezultuar me vrasje ose lëndim të rëndë trupor, nuk po amnistohet dhe është pak sa vënie në lajthitje e opinionit edhe e Kuvendit të thuhet që po amnistohen vrasësit. Nuk po amnistohen. Çështja e parë.

Çështja e dytë, të cilën e kemi kërkuar disa herë, jo vetëm në Kuvend të Kosovës, por edhe në konferenca për shtyp është që zyrtarët e shtetit, ata që kanë dhënë betim dhe ata që kanë nënshkruar kontratë me shtetin të mos amnistohen. Ne e kemi ditur, e kemi pasur të qartë, nuk kemi pasur lajthitje se ky provizion do të shkonte deri në tej për të kaluar përtej asaj çka po domi ne dhe të mund të aplikohet edhe aty ku nuk po dëshirojmë që të aplikohet, sidoqoftë prapëseprapë projektligji të cilin sot e kemi e plotëson në masë jashtëzakonisht serioze edhe këtë kërkesë të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, për shkak se kemi provizione taksative në bazë të cilave amnistohen veprat të cilat kanë qenë pjesë e thirrjes për rezistencë ose e refuzimit të njohjes së shtetit të Kosovës.

Dhe me të vërtetë kisha pasur dëshirë për ta parë ndonjë zyrtar të shtetit të Kosovës, ndonjë deputet, ish- deputet, ministër, ish- ministër, kryetar komune, ose ish- kryetar komune, i cili do të ketë guxim të aplikojë për amnisti duke u thirrur edhe vet në rezistencë ndaj shtetit dhe në mohim të shtetit të Kosovës.

Dhe çështja e tretë, ka qenë kompensimi, kompensimi i dëmeve që janë shkaktar për shkak të veprave penale dhe shpjegimi ynë ka qenë kështu. Nëse ne me amnisti e falim,

në një farë forme, një kryerës të veprës penale, shembull ta marrim të një uzurpimi të pronës, atëherë duhet të ketë provizion të qartë ligjor që i dëmtuari, atij të cilit i është uzurpuar prona të ketë mundësi që të aplikojë dhe të kompensohet për dëmin që i është bërë, qoftë uzurpim i pronës, qoftë ndonjë dëm tjetër ekonomik, ne e dimë që ka dëme të cilat nuk mund të kompensohen plotësisht.

Do të thotë këto kanë qenë tri kushtet tona, ne e shohim që ky projektligj në masë jashtëzakonisht serioze i plotëson këto kushte të cilat i kemi vënë herën e kaluar.

Tani nuk guxoj të mos i referohem një fenomeni që ka ndodhur në Kosovë gjatë javës së kaluar dhe ky fenomen ka pasur të bëjë ekzakt me këtë që e thash deri më tani.

Vota e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, javën e kaluar ka qenë për projektligjin në parim dhe është zhgënjyese të shihet që ka njerëz në Kosovë, ka edhe media në Kosovë që e përcjellin Kuvendin e Kosovës që prej vitit 2001 dhe ende nuk e kanë kuptuar që çdo projektligj votohet dy herë. Është jashtëzakonisht zhgënjyese të dëgjosh qytetarë, njerëz e posaçërisht mediat që e përcjellin Kuvendin e Kosovës të thonë që deputetët po flasin ndryshe, po votojnë ndryshe.

Tani vetëm dy mundësi ekzistojnë për dikë ta bëjë një deklaratë të tillë. Mundësia e parë është që as 12 vjet e gjysmë nuk u kanë mjaftuar për të marrë vesh qysh votohet ligji në Kosovë, që votohet në parim një herë dhe votohet herën e dytë pasi ta përmirësojë Kuvendi. Do të thotë 12 vjet e gjysmë nuk u ka mjaftuar ta marrin vesh rregullën më elementare të Parlamentit ose e kanë marrë vesh e me qëllim i denigrojnë deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Të dyja janë vërtetë zhgënjyese për cilindo njeri, për cilindo medium që pretendon se njeh politikë dhe e përcjell Kuvendin e Kosovës.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës edhe qytetarë të Kosovës, Kosova po jep amnisti, Kuvendi i Kosovës po jep amnisti, nuk po jep amnisti Kuvendi i Serbisë. Ne po japim amnisti. Pavarësisht se si mund ta interpretojë dikush dhënien e amnistisë kuptojeni atë që është më bazikja, kuptojeni atë që është më elementarja në këtë proces. Ne po u japim amnisti disa qytetarëve të Kosovës të cilët deri tash kanë refuzuar për ta njohur shtetin e Kosovës, kanë refuzuar të jenë pjesë e ligjit sikur të gjithë qytetarët tjerë dhe për një moment po u jepet mundësia për ta bërë një gjë të tillë.

Kështu e shih aleanca, kjo është arsyeja pse Aleanca e jep votën për dhe mendojmë se me votën sot do të nisë një proces, do të jetë një ditë në Kosovë e cila do t'u jep mundësi qytetarëve të Kosovës që të jenë qytetarë të cilët e respektojnë ligjin dhe rendin sikur të gjithë tjerët dhe gradualisht do të jenë pjesë solide dhe pjesë kontributdhënëse e shoqërisë kosovare në të ardhmen. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalë e ka kryetarja e Koalicionit për Kosovë të re, deputetja Myzejene Selmani.

**MYZEJENE SELMANI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Përshëndetje për zëvendëskryeministrat dhe ministrat të cilët janë prezentë në këtë seancë,

Përshëndetje për deputetët,

Duke marrë parasysh se në seancën e kaluar Koalicioni për Kosovë të Re i dha përkrahje projektligjit, mirëpo u deklarua se duhet të hiqet neni 3 i projektligjit të kaluar dhe Qeveria në këtë seancë ka sjell një projektligj në të cilin është hequr neni 3 i projektligjit për arsye se për Ligjin për amnisti kërkojmë që të integrohet veriu i Kosovës dhe njëkohësisht zbatimi i Marrëveshjes në mes Kosovës dhe Serbisë dhe konform asaj që ka kërkuar Koalicioni për Kosovë të Re për heqjen e nenit 3, Koalicioni për Kosovë të re e përkrah ligjin. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, nënkryetari Petar Miletqi e ka fjalën.

**PETAR MILETIĆ:** Poštovani gospodine predsjedniče Skupštine,

Članovi Vlade,

Koleginice i kolege poslanici,

Siguran sam da svako ko i delimično prati rad Samostalne liberalne stranke neće biti iznenađen našom današnjom odlukom da podržimo usvajanje zakona o amnestiji.

Uveren sam da je naša privrženost ideji okončanja konflikta i normalizacije odnosa poznata svima na političkoj sceni Kosova i svim građanima koji su za nju zainteresovani.

Naši razlozi za podršku ovom zakonu su dvostruki. Najpre smatramo da se njime stvaraju preduslovi da se pravno okonča konflikt na Kosovu, normalizacija na terenu, sprečavanje samovoljnog tumačenja zakona za period nerešenih odnosa pre svega na severu Kosova i uklanjanje straha od toga kod građana su naš prvi motiv da danas glasamo za usvajanje ovog zakona.

Istovremeno usvajajući zakon o amnestiji sprečavamo zloupotrebe prirodnog osjećaja straha pripadnika srpske zajednice pre svega na severu Kosova od eventualne političke odmazde.

Drugi naš razlog leži u činjenici da danas ne usvajamo samo jedan od mnogobrojnih zakona kojim trebamo da uredimo kosovsko društvo, pa čak i u setu zakona koje smo doneli a koji direktno proizilaze iz Briselskog sporazuma ovaj zakon se, zbog svega što se oko njega dešava, posebno izdvaja.

Mi zato danas, glasajući za ovaj zakon glasamo i za Evropsku budućnost Kosova i regiona. Samostalna liberalna stranka želi da se zahvali na podršci i pomoći Evropskoj uniji i Sjedinjenim Američkim državama da se proces normalizaciju odnosa ne prekine u ovom trenutku Briselskog sporazuma.

Posebno želimo da istaknemo i lično angažovanje visoke predstavnice Evropske Unije Ketrin Ešton i zvaničnika Stejt departmenta gospodina Filipa Rikera koji su svojim

posetama poslednjih dana ohrabрили institucije da nastave putem pomirenja, suživota i normalizaciju odnosa.

Amnestija predstavlja uobičajen pravni akt koji je u krivičnom pravu u opšte usvojen i koji poznaju sva savremena krivična zakonodavstva. Odmeravanje društvene koristi od okončanja konflikta sa jedne strane i činjenice da amnestija po svojoj prirodi ne predstavlja potpuno zadovoljenje pravde za najteža krivična dela, sa druge strane, čini amnestiju osetljivom temom.

Kada u kosovskom društvu koje je isuviše dugo post-konfliktno, amnestija dođe na red, logično je očekivati različite reakcije ljudi i već uobičajene zloupotrebe tih reakcija.

Prateći prištinske medije i slušajući izlaganja kolega poslanika vidi se da postoje dve suštinske vrste kritika na Nacrt zakona koji je pred nama. Jedno je potpuno odbijanje svake vrste amnestije i tvrdoglavo insistiranje da se konflikt ne završi na taj način i opet se pokazuje da zagovornici te ideje imaju istu argumentaciju kao i oni sa druge strane barikada. Jedina razlika je u nacionalnom predznaku.

Ako pogledate obrazloženje u zahtevu za ocenu ustavnosti zakona o amnestiji koji je dostavljen sudu u Prištini i obrazloženje u zahtevu za ocenu ustavnosti Briselskog sporazuma sudu u Beogradu uvidećete u govoru kritičara procesa normalizaciji odnosa ovih potpuno suprotstavljenih grupa da je sličnost ogromna.

Druga kritika ovog nacrtu fokusirana je na to da se amnestija ne odnosi samo na sever već se amnestiraju i krivična dela na delu Kosova gde su centralne vlasti imale kontrolu.

Za nas poslanike koji zastupamo srpsku zajednicu u Parlamentu to se može tumačiti kao unutrašnja stvar političkih partija kosovskih Albanaca. Ali mi na to tako ne gledamo.

Princip na kome insistiramo je da amnestija obuhvati sve pripadnike Srpske zajednice na Kosovu bez obzira što konflikt najduže traje na severu.

Nacrt zakona o amnestiji uvaživa ovaj princip a mi smo spremni da podržimo i svaki drugi predlog koji ovaj princip neće ugroziti.

Sve one dobre strane amnestije o kojima sam govorio, dakle pravno okončanje konflikta, oslobađanje ljudi straha od samovoljnog tumačenja zakona za dela iz perioda konflikta, moraju osetiti i Srbi južno od Ibra bez obzira što je proces integracije na ovom delu Kosova daleko više odmakao.

Mi insistiramo da se u svim procesima na Kosovu srpska zajednica sagledava u celini i da podela Srba na one severno i južno od Ibra može biti čak i politička u smislu uvažavanja njihovih geografskih specifičnosti ali nikako ne sme biti pravna u smislu selektivnog delovanja zakona za pripadnike srpske zajednice.

Ja se nadam da će izvršene izmene zakona o amnestiji koje se danas donosi u odnosu na ne usvojeni predlog od prošle nedelje Nacrta zakona učiniti prihvatljivim za što širu skupštinsku podršku. Ne smemo izgubiti iz vida da današnje glasanje kao i celokupne implementacije Briselskog sporazuma nema za cilj samo normalizaciju odnosa Beograda i Prištine već i normalizaciju odnosa između građana na Kosovu na čemu Samostalna liberalna stranka radi od svog osnivanja.

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+” nuk ka të lajmëruar. Fjala është për deputetin e Grupit “Zajednička Budućnost”, Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Poštovani uvaženi ministri,

Poštovani poslanici,

Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” je saglasna da se izmeni Nacrt zakona o amnestiji usvoji i podržace usvajanje istog. Hvala!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Lumnije Morina.

LUMNIJE MORINA: Faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Për herë të dytë po na vjen në shqyrtim Projektligji për amnistinë, por këtë herë pa nenin 3, për të cilin nen ka pasur shumë kritika gjatë debatit parlamentar javën e kaluar, për shkak të përmbajtjes së tij e cila ka qenë shumë skandaloze për shkak të veprave penale të cilat ishin përfshirë në të.

U ndjeva mirë që nga projektligji u hoq neni 3 dhe veprat penale që kanë rezultuar me lëndime trupore apo edhe me vrasje, mirëpo mendoj se është e domosdoshme që ky projektligj të bëhet edhe më i qartë, më i plotë dhe më i saktë në përcaktimin e qëllimit që mendohet të arrihet me të.

Duke pasur parasysh arritjen e këtij qëllimi, pra nëse duam t’u bie tamam atyre për të cilët është hartuar ligji siç e tha edhe zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, unë propozoj që nenit 1 të këtij projektligji t’i shtohet ky amendament: “Ligji vlen vetëm për ata persona të cilët nuk e kanë pranuar, njohur sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës”.

E bëj këtë propozim-amendament, sepse vetëm në këtë mënyrë bëhet krejtësisht e qartë se qëllimi kryesor dhe i vetëm i këtij projektligji është integrimi i veriut të Kosovës dhe qytetarëve të asaj pjese të vendit në sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës, në të kundërtën ky qëllim mjegullohet, bëhet i paqartë, i dyshimtë dhe si i tillë nuk mund të jetë në shërbim të vendit dhe të ardhmes së tij.

Unë e kam votuar marrëveshjen ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve mes këtyre dy vendeve, duke zgjedhur në mes të dëshirueshmes dhe të mundshmes, unë kam vendosur për të mundshmen, me bindje se



kjo marrëveshje do të jetë në shërbim të qytetarëve të dy vendeve dhe të së ardhmes së tyre më të mirë.

Po kështu mendoj edhe për Projektligjin për amnistinë, por të njëjtin nuk do ta votoj në qoftë se nuk plotësohet me propozim-amendamentin e lartpërmendur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca, nënkryetar i Kuvendit.

GLAUK KONJUFCA: I nderuar kryetar, Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Në çdo vend të botës ku vjen në shprehje përpilimi i Ligjit për amnistinë, kjo bëhet zakonisht në një formë të caktuar.

Ligji për amnistinë është një kontratë që shteti e vendos më një pjesë të qytetarëve të vet. Kjo ndodh pas kalimit prej një gjendje të caktuar politike dhe sociale në gjendjen tjetër, me ç'rast shoqëritë zhyten në kundërthënie të thella apo edhe konflikte të armatosura. Në Kosovë nuk është ky rasti.

Prandaj kur të analizohet Ligji për amnisti, duhet të vendoset në kuadrin e plotë politik në të cilin ai është propozuar, është draftuar dhe po sillet në Kuvend për miratim. Shtrohet pyetja: Cili është konteksti politik i këtij ligji?

Ky ligj nuk është kontratë mes shtetit të Kosovës dhe një pjese të qytetarëve të vet.

Në këtë ligj, pra, nuk i kemi si palë të vetmuara shtetin e Kosovës dhe qytetarët e amnistuar.

Ky ligj është kontratë e Qeverisë së Republikës së Kosovës me Beogradin që doli nga negociatat me Serbinë dhe ky është thelbi i ligjit, të gjitha të tjerat janë pasojë e kësaj.

Pra, nuk është se këtu po bën marrëveshje Kosova me disa prej qytetarëve të saj jolojalë ndaj shtetit, por Beogradi ka dalë si palë përgjegjëse për serbët e veriut dhe strukturat e tij shtetërore brenda Kosovës dhe Qeveria jonë kërkon që këtyre njerëzve t'u garantohet mos prekje dhe imunitet nga drejtësia e Republikës së Kosovës.

Si parakusht që Serbia të pajtohet me këtë amnisti, kërkoi fillimisht krijimin e asociacionit të komunave serbe, kompetenca ekskluzive në gjyqësor, polici, buxhet të pavarur, zhvillim ekonomik, planifikim hapësinor e të tjera.

Tash, ata të cilët për 14 vjet me radhë e krijuan rajonin e spastruar të veriut të Kosovës me dhunën e armëve dhe barrikadave të ngritura gjithandej, amnistohen nga Qeveria jonë, kurse Beogradi i vendos nëpër pozita udhëheqëse të autonomisë së veriut.

Problemi i dytë madhor i ligjit ka të bëjë me faktin që këtu ata të cilët po amnistohen, nuk është si qëllim të mbesin qytetarë të thjeshtë, të cilët do të merren me jetën e tyre personale.

Këtu amnistia po ndodh për njerëz, të cilët deri sot kanë zhvilluar aktivitet ilegal dhe antikushtetues, kurse tash me këtë ligj do ta kenë të drejtën të kandidohen për poste publike në Republikën e Kosovës. Ky ligj e kthen mbrapsht procesin e shtetndërtimit të Kosovës.

Logjika elementare e shtetndërtimit thotë se shteti tenton drejt imponimit të kushtetutshmërisë dhe rendit institucional, duke i forcuar ata që punojnë për këtë rend, si dhe duke u ndëshkuar dhe dobësuar ata të cilët e cenojnë dhe e sfidojnë këtë rend.

Këtu në Kosovë po ndodh e kundërta.

Të gjithë atyre qytetarëve vullnetmirë, atdhetarë dhe guximtarë, të cilët në vazhdimësi e kanë luftuar krimin në veri, në krye me heroin e rënë Enver Zymberi, ky ligj ua shkuptimëson përpjekjet dhe sakrificat që ata i kanë bërë.

Kurse të gjithë ata që e kanë luftuar pavarësinë, i kanë djegur kufijtë e Kosovës dy herë, kanë kontrabanduar, kanë rrahur shqiptarë në veri, i kanë përzënë ata, ua kanë uzurpuar banesat, i kanë terrorizuar në vazhdimësi, i kanë vjedhur, e kështu me radhë - të gjithë këta shpërblehen dhe trimërohen, sepse shikojeni në të vërtetë se çka po amnistohet. Po amnistohet, siç thuhet në ligj - cenimi i sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës, rrezikimi i rendit kushtetues dhe kryengritjet e armatosura.

Prandaj, po them se ky është prapakthim në procesin e i shtetndërtimit të Republikës së Kosovës.

Faktikisht, kjo është një sjellje që thotë se meqë nuk po mund ta luftojmë krimin, krimit duhet t'ia japim pushtetin, e kjo na çon në një situatë paradoksale, me ç'rast në vend që ligji të shërbejë si mjet kundër krimit, në të vërtetë, po kthehet si ombrellë të krimit e organizuar politik në Kosovë.

Një tjetër problem fundamental i ligjit është fakti se efektiviteti i tij kufizohet në kohë vetëm sa i përket vendosjes së limitit të fundit, por nuk e vendos fare pikënisjen e tij.

Shtrohet pyetja: Cila është data apo koha e saktë kur fillon amnistia e veprave të definuara në këtë ligj?

A përfshihen këtu edhe vitet e '90-ta, vetëm koha pas çlirimit të Kosovës, apo vetëm koha pas pavarësisë të Kosovës? Ligji nuk e definon këtë problem, dhe kjo përbën një problem të madh.

Po ashtu, ne si përfaqësues të popullit, duhet ta kemi parasysh edhe një gjë themelore, ashtu që ta mbrojmë Republikën tonë nga krimi i organizuar.

Në këtë ligj, nuk ka kurrfarë indikacioni se kemi të bëjmë me amnistinë e veprave kriminale vetëm në një pjesë të territorit të Kosovës, gjë që lë të kuptohet se ky ligj vlen

për gjithë territorin e Republikës sonë. Atëherë duhet t'i shtrojmë disa dilema, nëse është kështu.

P.sh. neni 3 - pika 1.1.15.2 jep amnisti, po citoj për 'parandalimin e ushtrimit të së drejtës për të votuar'.

Meqë ligji nuk reduktohet në një pjesë të territorit të Kosovës, atëherë a do të thotë kjo pikë se amnistohen të gjithë manipuluesit e zgjedhjeve në Kosovë.

Njëjtë edhe për nenin 3 - pika 1.1.15.5, me të cilin amnistohet 'shmangia nga tatimi'. Nëse kjo nuk reduktohet në veri, a mos do të thotë se po amnistohet krimi i organizuar i evazionit fiskal që na ka sjellë në Kosovë përplot milionerë të paligjshëm, të cilët janë edhe në politikë.

Po kështu vlen edhe për nenin 3 - pika 1.4.2 - amnistohet spiunazhi.

Nëse kjo nuk reduktohet në veri, a mos është qëllimi këtu të amnistohen strukturat e agjenturave të paligjshme në Kosovë?

Për të gjitha këto që i thashë për përmbajtjen e ligjit, nëse ky ligj kalon me këto që i përmenda, unë nuk gjej fjalë tjetër më të përshtatshme sesa të them se kjo paraqet fiasko të shtetit ligjor dhe bankrotim total të kësaj Qeverie.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Quni.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra, deputetë,

Akti i amnitisë është po aq i lashtë sa njerëzimi. Evidencat e para të amnitisë apo faljes janë që para 2 500 vjetësh. Individët, fiset, popujt kombet, principatat, mbretëritë, perandoritë e shtetit, liderët, gjeneralët, dijetarët, gjatë historisë së njerëzimit kanë falur dhe kanë qenë të falur. Nuk ka shtet apo komb që në zhvillimin e vet nuk është përballur edhe me përvojën e faljes.

Luftërat, revolucionet, rebelimet, konfliktet, përmbysjet e regjimeve, puçet ushtarake, krizat ekonomike, anarkitë, katastrofat natyrore e tjera, gjithnjë shoqërohen edhe me konfuzion, pasiguri, frikë, dhunë, padëgjueshmëri, mosbesim, krime, kontrabandë e tjera. Pas qetësimit të gjendjeve, fituesi, sovrani, në përpjekje për ta siguruar rendin dhe ligjin, përparimin, unitetin, miqësinë, është përballur edhe me faljen edhe të një pjese të atyre që e kundërshtonin, apo edhe vazhdonin ta kundërshtojnë.

Ne sot duhet të vendosim si të pozicionohemi karshi atyre që me dekada na përbuznin dhe nënçmonin, që me vite ishin shërbëtorë të makinerive të dhunës, të atyre që i humbën të gjitha betejat dhe luftën dhe që nuk e besonin se një ditë ata do të braktisen nga liderët dhe pushtetarët e tyre.

Çdo ditë e më shumë ata binden se ishin instrument i regjimeve, viktima të politikave, mjet i kusuritjeve. Sot janë të frikësuar nga shteti i ri, nga hakmarrja, dominimi, dhe me gjysmë zëri na kërkojnë falje.

Edhe pse kërkesa e tyre për falje, jo e drejtuar burrërisht, por e maskuar me gjuhën diplomatike në formën e ligjeve dhe neneve dhe me qëndrimet e konstatimit të ndërmjetësuesve të zhdërvjelltë, ata në thelb kërkojnë t'i falim.

Ne si komb dhe si shtet i kemi këto mundësi: t'i injorojmë dhe ta mbajmë gjendjen e tanishme; t'i luftojmë me të gjitha mjetet institucionale dhe format ligjore për ta vendosur rendin dhe ligjin dhe, në fund, t'i amnistojmë si parakusht për integrim brenda shoqërisë së Kosovës.

E para nënkupton vazhdimin në theksimin e problemeve ndëretnike, regjionale, ekonomike, të zbatimit të rendit dhe ligjit, të lëvizjes së lirë, të investimeve nga jashtë, të integriteteve euroatlantike e tjera.

E dyta nënkupton ngritjen e plotë të kapaciteteve policore dhe ushtarake, ndërmarrjen e operacioneve me rrezikshmëri të lartë, ngritjen e padive, arrestime dhe gjykimet e mijëra të qytetarëve të nacionalitetit serb, ngritja e infrastrukturës masive të qendrave të burgimit.

Qasja e tillë do të kërkonte mbajtje për një kohë të gjatë dhe në masë të madhe të mekanizmave të sigurisë në nivelin më të lartë të gatishmërisë në territoret me shumicë serbe. Kjo qasje është kopje e mënyrave të regjimeve që tani dënohen nga njerëzimi i qytetëruar.

Mundësia e amnistisë është më racionalja, më e menaxhueshmja, me pasojat më të vogla, më njerëzore dhe humane, më e qytetëruar. Të mos harrojmë se amnistinë gjithnjë e ofron, dhuron, zbaton ai që është më i fortë. Amnistia i jepet të dobët. Në këtë rast, ne jemi fituesit, ne jemi të fortit dhe ne falim. Ne i japim mundësi dialogut, paqes dhe ne i hapim perspektivat.

Për aktin e amnistisë, ne duhet t'i referohemi traditës dhe kulturës sonë shqiptare, Kanunit të Lekë Dukagjinit, ku në thelb është falja dhe paqja, besimeve tona islame dhe krishtere, që për mesazh kryesor e kanë paqen dhe faljen, praktikave civilizuese të pajtimit, marrëveshjeve, faljeve, kërkim-faljeve e tjera. Unë po ashtu i referohem edukimit tim në frymën e filozofisë rugoviane dhe përfundimisht, si ish-luftëtar, me kulturë ushtarake para trimërisë, prioritet i jap bujarisë.

Kam besim të madh në kolegët e mi, ekspertë në fushën e drejtësisë, se me procedimin dhe shqyrtimin e Ligjit për amnisti nuk do të lejojnë të na përvidhen edhe ata që i kanë duart të përlyera me gjak, që janë shkaktarë të vuajtjeve dhe dhembjeve. Ata, në asnjë rrethanë dhe me asnjë çmim, nuk duhet të mbërrihen, të lirohen apo të përfitojnë nga ky ligj. Vrasësit, në çfarëdo motivi, me ngulm të madh duhet të sillen para organeve të drejtësisë. Ata janë e keqja e çdo kombi dhe e çdo shoqërie.

I nderuar kryeministër,  
Zëvendëskryeministra,  
Ministra,

Në nenin 3, në versionin e parë të ligjit, ju e listuat një numër të madh të veprave kriminale. Ju edhe për ata kërkuat amnisti apo lehtësime të ndryshme. Ju kërkoj që të mos e hidhni nenin 3, por e dorëzoni në Prokurori dhe pranë çdo veprë shënoni emrat e bartësve të krimit, se ju duhet ta dini se kush janë ata. Në mesin e tyre ka profiterë të luftës, vrasës me motive politike, sabotues të proceseve demokratike, haraçmbledhës dhe njerëz të nëntokës, vjedhës të Dhomës së Dëshmime, të korruptuar dhe bosët e krimit të organizuar. Jo pak prej tyre janë të maskuar me petkun e zyrtarëve, të patriotëve dhe e luajnë rolin se fati i mirë i Kosovës varet nga sakrifica, guximi dhe mençuria e tyre.

Është e gjatë lista e atyre atdhetarëve, intelektualëve, ushtarakëve, policëve, deputetëve që u vranë në prita, në detyrë, prapa shpine, në shtëpitë e veta, në errësirë. Vrasësit e tyre duhet të gjenden me çdo kusht dhe nuk luan rol nëse ndodhen në veri apo në jug, serbë apo shqiptarë, se ata janë llumi i shoqërisë sonë, ata janë turpi i çdo kombi.

Ne sot jemi para një vendimi të rëndësishëm. Me siguri nga gjeneratat që vijnë, do t'i nënshtrohet gjykimit. Jam më se i sigurt që do të thuhet se ne shqiptarët, për të parën herë, e përdorëm edhe intelektin, përveç muskujve, që nuk luftuam kot, që e kapitalizuam fitoren, e ruajtëm miqësinë me aleatët tanë dhe jam më se i sigurt që ato gjenerata do të jenë falënderuese për vendimet që ne sot do t'i marrim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Buzhala e ka fjalën.

BERAT BUZHALA: I nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

“Në politikë, sikur në jetën e përditshme, nuk ka asgjë më të pavlerë dhe më të kotë se sa moralizimi. Megjithatë, disa njerëz e shohin këtë gjest si shumë atraktiv, sepse i shpëton prej detyrës për t'u thelluar në esencën e problemit”, shkruan Lev Davidovich Bronshtein, i njohur si Leon Trotsky, shkruan në librin e tij “Korrespondencë nga luftërat ballkanike”.

E citova këtë personalitet të njohur botëror të fillimin e shekullit të kaluar, jo pse i njëjti i ka lënë botës ndonjë trashëgimi të çmuar në fushën e filozofisë, sepse kjo nuk është fusha e tij më e ndritshme, por sepse thashë mos ndoshta ‘trockistët’ e ditëve të sotme revolucionare, të vetmuar të shekullit XXI, së paku një citim të babait të revolucionit permanent nuk do të ma marrin për të keq, edhe pse e kundërta nuk do të më mërzhiste fare.

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ju dhe ne jemi lodhur këto ditë me moralizime rreth kësaj çështjeje. I madh dhe i vogël, të shumtët pa e lexuar ligjin, të tillë e konsideroj edhe atë që e lexon e nuk e kupton, apo edhe atë që e lexon, e kupton, por e transmeton qëllimshëm gabimisht. Po moralizojnë

sesi nëse aprovohet ky ligj më së shumti do të dëmtohen ata që nuk do të përfitojnë prej tij dhe që 14 vjetët e fundit paskan qenë qytetarë të ndershëm të kësaj republike. Pra, po besoj se për këtë lloj moralizimi e kishte fjalën Trotsky.

Është një lloj tjetër moralizimi, veç këtij, i cili është shumë në trend ditëve të fundit, se ligji është i keq vetëm për faktin se në krye të tij nuk shkruan se ky ligj vlen vetëm për pjesën veriore të territorit të Kosovës, se ky ligj vlen vetëm për serbët e asaj pjese, apo edhe e pjesës tjetër. Se ky ligj do të quhej në rregull, sipas këtyre moralizuesve, po qe se aty do të shkruante se prej përgjegjësisë penale do të liroheshin punëtorët e sigurimit shtetëror, rojat e urave, të kullave e tjerë e tjerë.

Të parin, atë që e përmenda më lart, kryesisht e përdorin revolucionarët vetmuar të këtij shekulli, kurse të dytin e përdorin të gjithë ata që dëshirojnë ta okupojnë hapësirën mediale, duke u rreshtuar prapa demagogjisë dhe moralizimeve populiste, por, në anën tjetër, edhe më tutje po shpresojmë që mos t'i këpusin edhe fijet e fundit të donacioneve për regionet e tyre me miqtë ndërkombëtarë.

Për këtë kategori, thesari popullor e ka rezervuar një thënie të bukur: “Kryet te nëna, e pjesën tjetër të trupit te burri”. Pra, e konsiderojnë veten edhe më tutje pjesë të dy taborëve. Gjoja e dëshirojnë dhe e kuptojnë amnistinë, por gjoja u pengon paqartësia. Gënjeshtër! E vërteta është se ky grup i njerëzve, që aktualisht po organizojnë nënshkrime nëpër sheshet e ndryshme, ose nuk e kuptojnë, ose nuk e dëshirojnë amnistinë, sepse ata për një tjetër qëllim po i kërkojnë nënshkrimet, e për një tjetër po i marrin.

Nënshkruesit e këtij peticioni, që janë qytetarë të nderuar të Republikës sonë, nuk e vrasin shumë mendjen për mënyrën se si është shkruar ky ligj dhe nëse aty është vënë filan paragrafi, para filan neni. Ata qytetarë thjesht janë të shqetësuar me të drejtë me vetë konceptin e faljes. Pra, janë të shqetësuar pse ata që deri dje paskan punuar kundër rendit kushtetues të Kosovës, që deri dje paskan bërë kontrabandë, i paskan djegur pikat doganore, sot po falen. Pra, pse po falen ata qytetarë që Republikën e Kosovës e kanë parë si pengesë, e jo si mundësi?

Më lejoni që të provoj ta jap një përgjigje të shkurtër në këtë çështje. Po falen, sepse po kërkojnë të falen. Edhe më tutje, ata nuk po kërkojnë falje për krimet që i kanë bërë këtu, mirëpo definitivisht janë duke kërkuar që ne t'ua falim një pjesë të fajeve.

Të nderuar qytetar të kësaj republike,

Kur ka ndodhur më herët në historinë tonë që kryeministri i Serbisë të mbajë shikimin kah puna që ne po e bëjmë? Kur ka ndodhur më herët, madje as kur e kemi shpallur pavarësinë, që kryeministri i Serbisë të presë prej nesh që ne ta falim komunitetin serb pse e ka cenuar rendin kushtetues të Kosovës? Pra, nëse ne ua falim atyre krejt çka ata kanë bërë deri në muajin qershor, kjo nënkupton se ata, edhe Daçiq, që po supozoj që po na përcjell, po e pranojnë rendin aktual kushtetues të vendit tonë.

E rendi kushtetues i vendit tonë është se Kosova është shtet i pavarur, sepse askush nuk kërkon të amnistohesh prej një vepre, deri në një datë të caktuar, kurse pas asaj date, i njëjti, me të njëjtën gjakftohtësi ta përsërisë të njëjtën vepër, kurse dikush kërkon amnisti, sepse e ka ndërmend të sillet si qytetar i përgjegjshëm i kësaj republikës sonë.

Ata dhe askush nuk do të amnistohet për veprat që e cenojnë rendin kushtetues tash e tutje dhe këtë po e kërkojnë edhe vetë. Pra, Qeveria e Republikës së Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Presidenca, me gjasë do ta mbyllin një kapitull të lodhshëm dhe të dhimbshëm dhe të gjatë plot 14 vjet në një pjesë të territorit të Republikës tonë.

Të kota dhe të pavlera, siç do të thoshte Trotsky, janë moralizimet e mëtejshme rreth kësaj çështjeje. Kot ne sot humbim kohë në zbulimin e shkaktarëve se si do të ndihen tash ata banorë që e paskan respektuar shtetin për kaq e kaq vite. Ata banorë që e kanë respektuar ligjin në këto 14 vjet më parë pandërprerë, sot do të duhej të ndihen tepër të gëzuar.

Të lumtur dhe të gëzuar sot duhet të ndihen të gjithë ata biznesmenë që nuk kanë nevojë të amnistohen prej këtij ligji, sepse nuk do të kenë konkurrencë jolojale në një pjesë të territorit. Të lumtur dhe të gëzuar duhet të ndihen sot ata punëtorë shëndetësorë që e kanë respektuar ligjin, sepse atyre sot u bashkohen edhe një pjesë e kolegëve, që nuk e kanë respektuar.

Të lumtur dhe të gëzuar duhet të ndihemi të gjithë ne që kemi besuar në Republikën e Kosovës, sepse sot po na bashkohet një pjesë që nuk ka besuar në të.

Të pikëlluar do të ndihen vetëm ata që e kanë shpresuar që Konferenca e Rambujesë nuk do të sjellë kurrfarë të mire. Të pikëlluar duhet të ndihen të gjithë ata që kanë besuar që bisedimet e Vjenës po e çojnë vendin drejt inkuadrimin në Serbi. Të pikëlluar duhet të ndihen ata që kanë hedhur gurë e dru mbi planin e Ahtisarit.

Problemi esencial, të nderuar kolegë deputetë dhe qytetarë të Republikës së Kosovës, nuk është më në veri të vendit, sepse ata kanë vendosur që ta njohin pavarësinë e Kosovës, ose nëse dëshirojmë të jemi pak më skeptikë, kanë vendosur ta provojnë pavarësinë e Kosovës. Problemi është tash ndërmjet këtij Kuvendi, te një tufë deputetësh, që edhe më tutje nuk e njohin, e as nuk besojnë në këtë subjekt juridik dhe në këtë rend juridik.

Këta deputetë, prandaj nuk e duan miratimin e këtij ligji, sepse po shpresojnë se do ta humbin një aleat, një partner në kauzën e tyre. Askënd nuk ka nevojë që ta brejë ndërgjegjja për votën pro këtij draftligji. Të jeni të bindur që ata që sot fshihen prapa emrave të Selverit, të Enverit, nesër do të donin të fshiheshin prapa emrit tuaj të vdekur. Këta kërkojnë të fshihen prapa të vdekurve, kërkojnë të fshihen prapa heronjve, por kjo nuk i bën ata të tillë. Këta janë një grup fundamentalistësh politikë shumë të dyshimtë në agjendën e tyre që vendin tonë po provojnë me tërë kapacitetin e tyre ta nxjerrin prej binarëve.

Në emër të atdhedashurisë, këta e vrasin atdheun, kurse në emër të lirisë këta e vrasin lirinë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë vazhdoj të mendoj se Projektligji për amnistinë i ka, edhe kështu siç ka ardhur, tri defekte themelore, defekte të cilat i kam thënë në seancën e kaluar. Do t'i bjer shumë shkurt.

Së pari, ky projektligj përfshin vepra penale kundër individit, përveç atyre që janë kundër rendit kushtetues. Kjo është e patolerueshme. Kjo bie në kundërshtim edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por po ashtu edhe me Kushtetutën e Kosovës.

Defekti i dytë themelor - i mungon data prej ku duhet të fillojë amnistia. Deri më 17 shkurt 2008, në pjesën veriore për shembull kanë funksionuar gjykatat, kështu që pse do të duhej të kishte amnisti pa një datë fillestare. Në rast se do të bëhet kështu, atëherë ky ligj do t'u mundësojë zjarrvënësve gjatë luftës '98-'99 që të amnistohen, zjarrvënësve të 200 mijë shtëpi të shqiptarëve. Po e përmend vetëm këtë vepër penale për ta kuptuar dimensionin. Kjo vepër penale është e përfshirë në këtë projektligj, pra zjarrvënia.

Defekti i tretë themelor, mungon përcaktimi i grupacioneve, të cilat për qëllime politike e kanë kundërshtuar rendin kushtetues të Kosovës, ose nuk e kanë njohur rendin kushtetues. Mendoj se Qeveria e Kosovës, duke na e sjellë këtë projektligj, po e kontrabandon amnistimin e veprave të tjera penale, pra veprave kundër individit, në emër të amnistisë politike.

Heqja e nenit 3 është vetëm kozmetikë, në fakt neni 5, duke qenë se publiku e njeh kështu, i projektligjit të kaluar, që tashmë ka një numër tjetër, është shumë më i rrezikshëm se ai nen. Nuk mendoj se duhet të ketë amnisti të përgjithshme. Mendoj që arsyet se pse kjo po bëhet, pra pse bëhet një amnisti e përgjithshme, e jo një amnisti vetëm për ato grupacione, të cilat nuk e kanë njohur rendin kushtetues të Kosovës, po bëhet për arsye elektorale.

Po kështu, nuk më pëlqen fare që Beogradi po na rri mbi kokë si xhandar për të parë se çfarë votojmë ne e çfarë jo. Mendoj që Beogradi dushet t'i kryejë detyrat e veta, të cilat gjithashtu lindin nga marrëveshja, që është firmosur në Bruksel, dhe që këtyre detyrave as që ua ka filluar nga puna. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Trajković e ka fjalën.

RADA TRAJKOVIĆ: Poštovani kolege poslanici,

Amnestija je čin koji se uvek tretira kao čin koji treba da dovede do nečega, što podrazumeva stabilizaciju. Mene, na jedan način, zabrinjava nemogućnost ovog parlamenta da na jedan otvoren i iskren i konkretan i etnički progovori da zakon treba da



bude etnički primenjen na Srbe koji žive na severu Kosova i Metohije. Kao razlog je rezultata integracije tog prostora u jedinstven prostor Kosova i Metohije.

Vi znate, i svi mi znamo, da naš region nažalost imao je mnogo problema u smislu hapšenja, izolovanja ljudi, koji su osumnjičeni za određena vrlo teška krivična dela, pa su donete odluke ili donešene odluke koje su imale konkretno i jasno etnički predznak. Želim da vas podsetim, ne mislim da je gospodin Vojislav Koštunica i do dana današnjeg amnestiran od dela srpske javnosti, zato što je oslobodio Albance, koji su bili pod zatvorima u Srbiji nakon okršaja koje su se dešavale na ovom prostoru. I tada, i sada, uvek sam pripadala ljudima koji su vrlo snažno podržavali oslobađanje tih ljudi.

I jako mi je drago da među njima budu normalna moja koleginica Flora Brovina, i jako mi je drago da je bio i gospodin Albin Kurti. Za njih se veliki deo intelektualne javnosti Beograda potpisivao i molio da izađu iz zatvora. Isto tako, vrlo odgovorno, a ne baš lako je primenjen etnički princip i u Makedoniji. Makedonsko rukovodstvo, makedonski narod sigurno nije sa ljubavlju i sa odobravanjem prihvatio da oslobodi ljude koji su podigli pobunu, ali su ipak to uradili na jedan isto tako odgovoran način.

Zašto samo ovde, i zašto samo u ovom parlamentu i unutar institucija Kosova ne može gotovo nikada da se stare srpski, ne može da važi da je amnestija za Srbe, jer to bode oči, ne mogu da uđem sa kolima beogradske registracije u krugu ispred Skupštine, pa makar ne znam koliko imalo potrebu, jer to je beogradski, iako ispred se parkiraju i Tirana i međunarodna zajednica, i Bosna i ne znam šta, ne može predsednica Kosova da napiše, iako je bila odlično primljena, i svi su se radovali poseti Dečanima, da je obišla Srpsku kulturnu baštinu i Srpski pravoslavni manastir, ne može da se dobije ili provere da imamo srpske pasoše ili srpsko državljanstvo? Zašto kolege ne pomognete mi, i ne pomognete svim Srbima koji ostaju da žive na ovom prostoru, i pomažu da bude multietnički jer se nalazimo na donjoj granici multietničnosti, da jasno podržite da živimo i ostanemo onakvi kako jesmo, kao Srbi.

Ne bih glasala 'za', bila bih uzdržana, jer suviše bi bilo teško da glasam protiv amnestije, ali ću glasati 'za', ne zato što me ubeđivao neko od lidera kosovskih institucija, jer im već odavno ne verujem, ali poštujući međunarodnu zajednicu, koja će valjda biti garant i koja valjda zna jer ja ne znam koliko Srba se nalazi i koliko Srba ima dosje koje treba da se amnestiraju. Niko od nas ne zna broj tih ljudi, niko ne zna ni ko su ni šta su, ni koja dela, ni na koji način, i niko od Srba ne veruje da neće se kao što se dešava ispod Ibra, stalno montirati slučajevi hapšenja ljudi sa dva svedoka koji navodno su videli ubistva, pa mnogi Srbi su nakon ležanja dužeg vremena po zatvorima oslobađani, a neki bogami i pretrpeli velike bolove.

Dakle, poštujući predstavnike međunarodne zajednice sa kojima sam razgovarala, ja ću danas dati glas Zakonu, a računam da moj narod neće biti žrtva i pored Zakona novih montiranih procesa.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Duhet ta përsëris një fjalë të urtë, e cila thotë: “Gabimi më i madh është kur nga dy alternativa jo të mira, i zgjedh të dyja”. Për fat të keq, po e përsëris, sepse po na përsëritet kjo dukuri. Dhe, kur ndodh kjo, zakonisht bëhen dy gabime. Ne në këtë rast po i bëjmë tri.

Një e paraqesim si të përkrahur, si të drejtë, si më të mirën të mundshme, një zgjidhje që hapur nuk është e tillë. E dyta, e kundërshtojmë në emër të kësaj pastaj një nevojë që është e pakundërshtueshme, Për të qenë më konkret, Kosovës i duhet amnisti, i duhen hapa të tillë, i duhet prandaj edhe Ligji për amnisti. Nuk bën të kundërshtohet kjo, por a është ligji i tillë çfarë na ka ardhur. Na është sjellë një ligj për amnistinë, që nënkupton amnisti të përgjithshme. A është amnisti e përgjithshme, ju lutem? Nuk është.

Prandaj, duke i bërë dy gabimet, ne pranojmë në fakt diçka që nuk është e pranueshme, e zhvlerësojmë me kontestimin e saj edhe përtej asaj që është e kontestueshme në ligj, dhe për më tepër gabimi i tretë që e bëjmë, konfrontohemi mbi këtë bazë, pa asnjë nevojë, në vend se të bashkohemi dhe ta gjejmë zgjidhjen e duhur.

Zonja e zotërinj,

Qasja ime, edhe përpara, edhe sot është kjo: Të gjejmë zgjidhjen e drejtë, që nuk do të thotë se qëndron gjithmonë ndërmjet dy skajëve, ndërmjet dy qasjeve të gabuara, prandaj unë propozoj që në fillim, e më vonë do të përpiqem ta arsyetoj, që këtë ligj që na ka ardhur kështu siç na ka ardhur, ta quajmë ashtu siç është përmbajtja e tij. Ligji duhet të titullohet konform përmbajtjes së tij. Ligji nuk është amnisti e përgjithshme, le të mos e trajtojmë si amnisti e përgjithshme. Është amnisti e pjesshme, le ta trajtojmë si amnisti të pjesshme parciale. Tani në procedurë, edhe në shumë shtete ka ligje për amnisti parciale, edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në disa vende tjera.

Dhe, meqë ligji është specifik, le ta theksojmë edhe specifikën e këtij ligji si ligj për amnisti të pjesshme për integrim, nëse kjo shprehje është motivi kryesor dhe efekti kryesor i këtij ligji.

Në këtë mënyrë, ne i përmbushim kërkesat edhe të miqve, edhe të atyre që nuk janë bash miq, edhe atyre që kanë qëllime të mira, edhe atyre që nuk kanë qëllime bash të mira, dhe besoj i përmbushim edhe vërejtjet e atyre që e kontestojnë, edhe motivin e atyre që e përkrahin me entuziazëm, dhe mund të dalim siç duhet. Dhe, kjo do të nënkuptonte që në amendamentim të ndryshohet kjo, do të thotë titulli, dhe konform të saj pastaj të specifikohen veprat që janë të amnistisë të pjesshme, të përfshihen në këtë ligj.

Veprat që nuk janë të amnistisë së pjesshme, por do duhej të ishin të amnistitë të përgjithshme, të veçohen dhe të theksohet se ky ligj është pjesë e legjislacionit për amnistinë e përgjithshme që do të vijë më vonë. Dhe, të veçohen veprat që do të përfshihen në këtë amnisti të përgjithshme. Të veçohen edhe veprat penale që janë të paamnistueshme, të cilat për fat të keq i kemi edhe në këtë ligj, i kemi pasur edhe në

nenin 3, i kemi edhe nenin e tashmë 3, e më parë 5, dhe mendoj që, nëse janë ‘Caus belli’ janë pikërisht ato. Amnistohet ajo që është e amnistueshme.

Në këtë mënyrë besoj që do të dilnin prej situatës kontradiktore, në të cilën jemi ndodhur.

Për ta arsyetuar pak më shumë këtë që e thashë, unë do të dëshiroja që duke i falënderuar të gjithë ata që kanë ndihmuar, ‘na keni ndihmuar’ do të thoshte dikush shumë! Faleminderit, megjithatë. Por, do t’i lusja megjithatë ta lexojnë së paku ligjin, për të cilin po na fajësojnë se nuk e kemi lexuar ne. T’i lexojnë edhe ligjet për amnistinë në fqinjësi edhe në Serbi, edhe gjetiu. Le t’i krahasojnë, le t’i krahasojnë me praktikën e tyre dhe le ta shohin a do ta votonin ata në vendin e tyre, ose a do të na sugjeronin ne që të votojmë diçka të tillë. Ne, megjithatë, duhet të jemi gjithmonë mirënjohës.

Do të dyshoja po ashtu që të mos e përdorim shumë këtë faktorin ndërkombëtar këtu, ose nëse e përdorim le të kemi parasysh se, përveç atyre që po e kontestojnë, ka edhe një përzierje, për mua krejt të pazakonshme, krejt jonormale të një vendi fqinj në një çështje shumë të brendshme, krejt të brendshme. Nëse, ta zëmë, kryeministri i Republikës së Serbisë thekson se miratimi i Ligjit për amnistinë, qysh ata e duan është kusht për procesin e normalizimit, shtrohet çështja: Me ç’të drejtë ai kërkon diçka të tillë?

Është thënë në fillim që ky proces duhet të jetë i pakushtëzuar. Çka janë tash këto kushte?! Dhe, si mund të kushtëzohet si kusht për zbatim një marrëveshje, të cilën Serbia nuk e ka ratifikuar. Nuk po e zbaton vetë. Madje, edhe në çështjen që po e diskutojmë. Nëse flasim për pajtim, pajtimi është një dans, si të thuash një “tango” me dy palë. Çka po bën Serbia në këtë proces? A po e zbaton të njëjtën qasje, ta zëmë, ndaj problemeve në Luginën e Preshevës etj.? Çka ka të keqe nëse kërkohet që kjo çështje të zgjidhet edhe këndeje kufiri, edhe andej kufirit.

Për më tepër, ky ligj po na silltet me urgjencë dhe vërtet shtrohet puna, pse kjo urgjencë? Pse me ‘hegjele’? Pse vonohemi? Vonohemi me 10-15 vjet dhe pastaj kur vjen puna ‘o, burra, përnjëherë’. Para dy ditësh e shqyrtuam dhe nuk kaloi, tani e kthejnë përnjëherë. Ka një praktikë që ligji që s’ka kaluar i do së paku disa muaj për të ardhur përsëri në Kuvend.

Pastaj, pse me kufizimet që po na sillen? Pse, për shembull, pa deklaratën financiare? A ka ky ligj impakt financiar? Afaristët e dinë. Nuk opinion, që unë s’dua t’i besoj se i kam rezervat e mia, po qarkullojnë shifra marramendëse. Logjike është që efektet financiare do të jenë serioze. Së paku do të duhej ta dinim çka po bëjmë.

Pastaj, ligji eka një kontradiktë brenda në dispozitat themelore, në preambulë, në memorandumin përcjellës dhe në dispozitat ekzekutive. Nëse është ligj bazik, e ne na mungon një ligj i tillë, atëherë do duhej të ishte i tillë. Nëse është akt për amnistinë, atëherë duhej të kufizohej në këtë.

Pastaj, është amnisti që këtu po thuhet nga të gjithë, ka të bëjë kryesisht me një komunitet. Por, pse atëherë shitet si multi-etnike? Pse atëherë shitet si gjithëpërfshirëse? Dhe, ndarja në këtë bazë, pa e specifikuar në titull, çka do të thotë? Do të thotë të

trajtohet si e përgjithshme, gjithëpërfshirëse diçka që është përjashtuese dhe është përjashtuese pa ndonjë kriter.

Thuhet: Po e bëjmë se po e kërkojnë disa. Megjithëse, ju lutem, kolegë deputetë, a jeni të informuar diku ju që këta që po përmenden këtu vërtet po kërkojnë. Unë do të dëshiroja të ishte kështu, po s'jam i bindur. Në atë kuvendin që e mbajtën të njëjtën ditë, që ne e diskutonim ligjin, u kërkua diçka tjetër. Pastaj te Kroji i Vitakut po jepet një mesazh tjetër. Në kufijtë e Kosovës gjithandej po jepet një mesazh tjetër.

Ligji ka bërë një ndarje të improvizuar. Nuk është e qartë çka amnistohet, nuk është e qartë çka përjashtohet. Ka plot paradokse, zonja e zotërinj. Ju lutem, vetëm lexojini ligjet, krahasojini këto nene dhe krahasojini me kodet penale që përmenden atje dhe do të ju shtrohen dhjetëra pyetje, të cilat unë s'mund t'i shtroj, sepse s'kam kohë. Por, do të dëshiroja që në ndonjë formë tjetër ta krijojmë hapësirën për t'i ballafaquar këto. Pse, për shembull, nga Kodi Penal i Kosovës, i Krahinës së Kosovës...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Në mesin e shumë arsyeve pse s'duhet votuar ky ligj, unë do t'i ndaj me ju dy që për ne janë dy më kryesoret, por jo të vetmet.

Arsyeja e parë është që ky ligj është derivat i një marrëveshjeje që ne në vazhdimësi e kemi kundërshtuar dhe ky është efekt i keq i asaj marrëveshjeje që ne e kemi kundërshtuar dhe e argumenton edhe një herë kundërshtimin tonë ndaj marrëveshjes Thaçi-Daçiç. Kjo është arsyeja e parë.

Arsyeja e dytë është që është ligj i keq, që nuk nënkupton që qytetarët e Kosovës, që Kosova nuk ka nevojë për një ligj, por është ligj i keq. Por, një arsye e tretë që më vjen tani për tani zakonisht jam i prirë të mos zbatoj urdhra dhe nuk dua ta zbatoj një urdhër, e aq më tepër kur ky vjen prej Daçiçit, dhe po ashtu një presion që vjen prej tij, sidomos pas mosmiratimit në herën e parë, në rastin e parë, që nuk dua ta quaj lexim të parë. Normalisht, ne kemi nevojë për një ligj, për një Ligj për amnistinë, një ligj i cili do ta rregullojë këtë problem në shtetin e ri të Kosovës.

Në anën tjetër, unë si deputet dhe ne si deputetë do të duhej ta ndienim kështu që ne kemi detyra vetëm para atyre që na kanë zgjedhur, kemi detyra para qytetarëve dhe kemi detyra ta mbrojmë interesin e qytetarit dhe të vendit tonë, gjë që duke e votuar kundër kështu ligj, mendoj që jemi në krye të detyrës sonë. Por, nga shumë deputetë këtu u dëgjuan edhe arsye shtesë për ta votuar këtë ligj, e një nga arsyet shtesë për ta votuar këtë ligj ishte edhe e heqja e nenit 3.

Po këta njerëz, këta deputetë, që sot e arsyetojnë votën për shkak se është hequr neni 3, si kanë votuar herën e parë, kur ka qenë neni 3? Shumë prej tyre e kanë votuar edhe me

nenin 3, dhe arsyeja pse e kanë hequr nenin 3 tash është e vetmja arsye shtesë për të votuar për shkak se edhe me nenin 3 shumë njerëz, jo të gjithë, e kanë votuar edhe në herën e parë, kur ka ardhur, e nuk ka kaluar me 2/3 e këtij Kuvendi.

Pra, pyetja është: Nëse ju sot po e votoni, pse e kanë hequr nenin 3, atëherë pse e votuat bashkë me nenin 3?

Nga komisioni përkatës, i cili e ka shqyrtuar me analizë të thellë këtë projektligj, erdhi një qëndrim se ky projektligj duhet të votohet shpejt, për shkak se është projektligj i ri. Do të duhej të ishte e kundërta. Nëse është projektligj i ri, nëse ka edhe rëndësi të vërtetë, nuk do të duhej të votohej shpejt, përkundrazi do të duhej të analizohej mirë, jo të votohej shpejt dhe arsyeja sa për ta pasur një arsye, zoti Gashi, e dha këtu, por nuk është arsyeja. Kurse nga përfaqësuesit e mazhorancës, që në këtë rast foli Behar Selimi në emër të saj, duke e arsyetuar këtë ligj, ai tha që me këtë ligj po zhbëhen strukturat paralele.

Zoti Selimi, kudo që të jesh, strukturat paralele nuk zhbëhen duke i stimuluar dhe duke i legalizuar. Ato struktura zhbëhen duke i zhbërë, gjë që nuk e bëtë kurrë edhe atëherë kur mundët.

Dhe, po ashtu, njëra ndër arsyet që ai i tha në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike ishte dhe arsye e ditës, ishte edhe se u hoq neni 3, grupi i cili edhe me nenin 3 e votoi në rastin kur nuk kaloi me 2/3 të Kuvendit.

Pra, kjo është një hipokrizi, që në këtë rast nuk e ka prekur cakun e destinacionit të kësaj hipokrizie. U tha nga grupet tjera parlamentare këtu, edhe nga pjesa e opozitës se ligji votohet dy herë. E tha zoti Gjini në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës se duhet të jemi të vetëdijshëm se ligji votohet dy herë.

Ne e dimë se ligji votohet dy herë, por e kam një pyetje: A votohet dy herë brenda të njëjtës ditë? A është leximi i parë sot dhe a do të jetë leximi i dytë pasdite, siç edhe mund të jetë, për shkak se vetë zoti Gjini ka qenë në mbledhjen e Kryesisë, ku është kërkuar që brenda të njëjtës ditë të bëhen dy leximet, dhe çka do të mund të ndryshonte nga leximi i parë në leximin e dytë, nëse kjo ndodh, e që uroj të mos ndodh, uroj të mos kalojë as në leximin e parë, pra uroj të mos ndodhë që leximi i dytë të jetë sot pasdite, me kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Pas moskalimit të këtij projektligji me 2/3 e leximit të parë, ju e dini, nuk kam nevojë të ju jap mend, ju e keni parë edhe në reagimet publike, i vetmi ose më së shumti i shqetësuar ka qenë kryeministri i Serbisë, Daçiq. Pra, njeriu i cili ka kërkuar me ngulm dhe e ka vënë si kusht për vazhdimin e bisedimeve, ka qenë kryeministri i Serbisë Daçiq dhe po ashtu ka qenë më i shqetësuar në rastin e moskalimit të këtij ligji. Ne do të duhej të kujdeseshim, jo me shqetësimin e Daçiqit, por me shqetësimin që kanë qytetarët dhe që shqetësimi i qytetarëve për këtë projektligj është shumë i madh.

Në mesin e gjithë atij presioni herën e kaluar, unë dua t'i falënderoj dhe dua që edhe një herë t'ua lakmojë kurajën shumë deputetëve me gjithë presionin që kanë pasur, shkak se presioni tashmë nuk është diçka e fshehur. Kanë votuar dhe kanë gjetur kurajë që ta

votojnë kundër këtë projektligj herën e parë kur ka ardhur në Kuvendin e Kosovës, në seancat e kaluara. Njëkohësisht, të njëjtit i ftoj që ta kenë të njëjtën kurajë dhe u garantoj respektin tim që ta votojnë kundër për shkak se kuraja e tyre mendoj që e shpëton moskalimin e këtij ligji, kuraja e tyre besoj që e shpëton që vërtet ne të mos e kemi një ligj të keq, por ta kemi një të ardhme me një kohë komode, një ligj të mirë.

Në të njëjtën kohë, i ftoj të gjithë deputetët që të mos e votojnë këtë projektligj për shkak se ai nuk i mbron interesat e qytetarëve të Kosovës. Ky projektligj mbron interesa jashtë këtij Parlamenti, mbron interesa jashtë qytetarëve të Kosovës dhe mbron interesa jashtë detyrave që kanë të zgjedhurit dhe përfaqësuesit e qytetarëve të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gjini, replikë.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Prapë po duhet ta përsëris se po bëjmë pyetje retorike, të cilat po e çojnë në lajthitje publikun, edhe Kuvendin, edhe mediat, disa prej të cilave 12 vjet e gjysmë nuk e kanë marrë vesh cila është procedura e votimit në Kuvend. Po thuhet, pse e votuat atëherë, pasi keni dashur të jetë ndryshe? Po ju tregojmë: dy votime janë. E kemi votuar në lexim të parë për t'i bërë ndryshimet që në lexim të dytë të mos i kemi ato provizione për të cilat po flasim.

Dhe, sikur të kishte kaluar javën e kaluar, sot ishim duke biseduar për lexim të dytë, pa ato provizione të cilat kanë ekzistuar dhe të cilat ne nuk i kemi dashur.

Tani sot do të votohet në lexim të parë tani, dhe pasdite në lexim të dytë, sipas të gjitha gjasave, për shkak se nuk është votuar herën e kaluar dhe për shkak se ndryshimet që i kemi kërkuar të bëhen prej leximit të parë në lexim të dytë kanë ndodhur tash para leximit të parë. Kjo është ajo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Selimi.

REXHEP SELIMI: Zoti Gjini, kthejuni pak kujtesës atë që ua keni premtuar qytetarëve. Ne nuk po tentojmë t'i vëmë në lajthitje qytetarët. Është e kundërta në këtë rast. Vërtet, grupi juaj është treguar shumë i zellshëm në votimin 'për' në leximin e parë. Asnjëri nga deputetët tuaj nuk ka votuar kundër. Madje është treguar shumë i zellshëm dhe përveç se është treguar i zellshëm në herën e parë, tani ju po tregoheni shumë të zellshëm. Unë uroj që ky zëri juaj të mos jetë efektshëm në përputhje me qëllimin.

Sidoqoftë, edhe një herë them që nuk e di çka do të mund të ndryshoni ju prej leximit të parë në leximin e dytë. As nuk e di çka do të mund të ndryshoni ju herën e parë nga leximi i parë, respektivisht në leximin e dytë. Pra, ndryshimi brenda ditës i ngjan një ndryshimi të shpejtë dhe gjithsesi hipokrit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,  
Ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,  
Sot nuk e kam ndërmend të diskutoj shumë për Ligjin për amnisti, pasi e kam dhënë mendimin tim në seancën e kaluar, por dua t'ia kujtoj koleges sime Rada Trajković: Metohija i ka vdekur bashkë me Slobodan Milosheviqin dhe le të mësohet e të adaptohet mirë në Republikën e Kosovës, të njohur tashmë ndërkombëtarisht.

Gjithashtu, kërkoj edhe nga udhëheqësit e seancave që në të ardhmen të marrin masa kur deputetët përdorin fjalor antikushtetues në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Në Rregullore dhe me Kushtetutë është përcaktuar kush çka flet në Kuvend dhe nuk mund t'i ndërhyjmë. Secili nga deputetët nganjëherë e shkel kodin që duhet, prandaj duhet të kihet parasysh. Fjalën e ka zoti Hoti.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryesues!

Ky projektligj, i cili më së miri tregon apetitet e Qeverisë së Serbisë, por edhe pa përjashtim kërkesat e strukturave të errëta të kësaj qeverie, është tendencë që këto struktura kriminale ta mbrojnë veten, ngase në këtë rast mbrojtja më e mirë e kësaj strukture është rehabilitimi i tyre.

Sa për të vënë në theks çka nënkupton ky projektligj për bandat dhe strukturat kriminale të Serbisë dhe të bashkëpunëtorëve të tyre në jug, vlen për të thënë disa çështje që do të na shpijnë deri te qëllimi dhe ngutja për ta miratuar një ligj të tillë.

Ivica Dačić ka disa ditë që në media proklamon se Ligji për amnistinë është ligj i cili i garanton serbët nga ndjekja e mundshme për veprat, të cilat autoritetet kosovare i konsiderojnë si vepra penale dhe të gjithë serbët që nuk pajtohen dhe nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, e përsëris pavarësinë e Kosovës. Pra, ky ligj i fal të gjithë ata që nuk e njohin atë shtet si të vetin, i liron ata nga çfarëdo ndjekje.

Deklarimet e tilla janë në përputhje të plotë me politikat e Serbisë në kohën kur as Dačići nuk ishte kryeministër. Vetëm për struktura paralele Serbia ka shpenzuar më se 2,2 miliardë për këto 14 vjet, që i bie se këto struktura i kanë kushtuar Serbisë afro 200 milionë euro në vit. Kjo i bie që me këtë Ligj për amnistinë ne do t'i legalizojmë këto shpenzime të Serbisë, e madje me këtë marrëveshje të kobshme do t'i marrim shumë nga to dhe përsipër në këtë buxhet të varfër të Kosovës.

Duke qenë se pikëkalimet kryesore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë ato në Jarin, Bërnjak, Merdar, Dheu i Bardhë, llogaritjet që janë bërë deri më tani rezultojnë se më se 40% e mallrave të importuara nga këto katër pikëkalime janë importuar në mënyrë ilegale dhe pa u evidentuar asnjëherë nga autoritetet e Republikës së Serbisë.

Të gjithë e dimë se tregu i zi i derivateve të naftës ishte tregu më joshës për kontrabanduesit, të cilët doni t'i falni. Vetëm nga viti 2008, kur është shpallur pavarësia e Republikës së Kosovës, e deri në korrik e vitit 2011, muajt kur Hashim Thaçi sa për sy e faqe tentoi të krijonte një spektakël të mbrojtjes dhe shtrirjes së sovranitetit, janë

importuar afro 670 milionë litra naftë, apo thënë me vlerë prej çmimit furnizues prej 550 milionë euro. Gjatë kësaj periudhe, vetëm në komunën e Mitrovicës, Zubin-Potokut dhe Leposaviqit janë hapur 40 pompa ilegale, të cilat e kanë paraqitur burimin kryesor për të dy bandat kriminale, ato në veri dhe në jug.

Dua të shtroj pyetjen për ju, kryeministër dhe zëvendëskryeministër, si sponsoruesit e këtij ligji, bashkëpunëtorët e të gjitha kompanive të naftës nga Serbia “Ad team”, “Luk yl” dhe “Knezhevic yl”, që kanë importuar më së shumti derivate të naftës për në Kosovë, sot, sipas jush, duhet të amnistohen dhe të shlyhen nga çdo dosje penale për veprimtarinë që e kanë bërë gjatë këtyre viteve.

Vetëm për të ju informuar se kompanitë si këto të lartcekurat kanë importuar vetëm brenda ditës 840 mijë euro dhe, sipas një studimi të publikuar ditë më parë, theksohet se bandat kriminale të veriut dhe atyre që ishin në bashkëpunim të jugut, kanë përfituar hiç më pak se 600 milionë euro vetëm këto pesë vjet nga shpallja e pavarësisë. Pra, ne së paku jemi duke i amnistuar disa dhjetëra-mijëra kriminelë, jemi gjithashtu duke i falur afro 1,4 miliard euro për kontrabandën, e cila ka lulëzuar për gjatë këtyre viteve, e që i bie që Kosova ka punuar një vit të tërë pa shpenzuar fare.

Për këta kriminelë që sot do të falen, më besoni se deri më sot, kur po procedohet ky projektligj, nuk e kam ditur se jemi aq zemërgjerë dhe kaq të pasur.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Haxhiu.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit! I nderuari nënkryetar,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është debatuar këto ditë aq shumë për amnistinë, sa pak ka mbetur vend që në Kuvend të thuhet diçka e re. I është kushtuar aq shumë vëmendje kësaj çështjeje, sikur të thuhej se amnistia për herë të parë po ndodh në Kosovë dhe duhet vlerësuar të gjitha debatet, edhe pse mënyra e kundërshtimit të amnistisë nga individët të caktuar po bëhet pa kurrfarë logjike dhe rezoni.

Fillimisht u tha nga ata se nuk do jenë pjesë e amnistisë vetëm serbët e pjesës veriore, por amnistia do të bëhet për të gjithë dhe për gjithë territorin.

Tani kur kjo ndodhi, sepse ishte kërkesë edhe e shoqërisë civile, edhe e subjekteve të caktuara opozitare, tani thonë se kështu nuk bën, sepse po përfitojnë edhe të tjerët, përveç serbëve të pjesës veriore. Bile, ata të cilët më së tepërmi po e kundërshtojnë amnistinë janë të njëjtit që më së tepërmi po përfitojnë nga amnistia.

Përfituesit më të mëdhenj nga amnistia, përveç strukturave paralele në veri, janë Lëvizja “Vetëvendosje” në jug. Anëtarëve të VV-sëdo t’u falen me dhjetëra vepra penale të shkaktuara kundër rendit kushtetues të Republikës së Kosovës dhe veprat e tjera huligane.

Por, le t’u falen, se po i amnistojmë rebelët në veri, prandaj le të falen edhe këta jug. Veç të shpresojnë, të mbledhin mend edhe ata në jug, edhe ata në veri, dhe nga tash e tutje të



mësohen ta respektojnë rendin kushtetues të Republikës së Kosovës. Prej periudhës të ratifikimit të marrëveshjes me Serbinë, e deri më tani ka qenë irituese për qytetarët e Republikës së Kosovës se si individë të caktuar po paraqiten në emër të shoqërisë civile, edhe pse janë puro politikisht të orientuar dhe me direktiva shumë të dyshimta.

Gjithashtu, është irituese për qytetarët e Kosovës që këto ditë, të bijtë e gjakpirësve të popullit shqiptar po paraqiten si “mbrojtës të interesit qytetar të Republikës së Kosovës”. Bijtë e gjakpirës të popullit shqiptar, baballarët e të cilëve ia pinë këtij populli gjakun me pambuk, ndërsa vetë ata që nga paslufta kanë qenë të punësuar, të sistemuar në organizata ndërkombëtare, bile-bile ishin edhe sahanlëpirësit e atyre organizatave ndërkombëtare, e sot dalin kundër organizatave ndërkombëtare dhe dalin në mbrojtje të interesit kombëtar, gjë që nuk do shumë koment.

Kjo i vërteton edhe dilemat që unë në këtë foltore i kam ngrehur për individë të caktuar, andaj sot ndihem mirë që veprimtaria e këtyre individëve është kuptuar nga qytetarët e Republikës së Kosovës dhe, nga 2 milionë banorë sa ka Republika e Kosovës, protestat e tyre nuk janë përkrahur hiç më tepër se nga 200 persona, apo kthyer në përqindje, nga 0,01% e popullit të Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Këto ditë ishim dëshmitarë të një iniciative për mbledhjen e nënshkrimeve për një petition kundër Ligjit për amnisti, duke i respektuar nënshkrimet e çdo qytetari të Republikës së Kosovës si veprim legjitim dhe kushtetues. Dua të theksoj se 7 mijë nënshkrime përbëjnë vetëm 0,4% të qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët e kundërshtojnë Ligjin për amnistinë. Ndërsa, 99,6% nuk e kanë nënshkruar këtë petition, që i bie se ata e përkrahin Ligjin për amnistinë, apo mund të themi lirisht se mbi 99% e qytetarëve të Republikës së Kosovës e përkrahin Projektligjin për amnistinë.

Dhe, krejt në fund, duke e kursyer kohën tuaj, të nderuar kolegë deputetë dua të propozoj që edhe mashtrimi, sipas nenit 261 të Kodit të vjetër, dhe 335 të Kodit të ri, të jetë pjesë e amnistisë dhe këtë për dy arsye: 1. Liderët serbë të veriut që 14 vjet e kanë mashtruar popullatën në veri se janë duke jetuar në Serbi dhe se ajo pjesë do të jetë Serbi, gjë që nuk doli të jetë ashtu, dhe 2. Një pjesë e opozitës këtu ka deklaruar se ajo pjesë do të jetë Republika Sërpska, apo autonomi, dhe pasi të dyja palët e mashtruan popullin dhe asnjëra palë të mos ndiqet penalisht për mashtrim, mendoj se duhet që mashtrimi të amnistohet me këtë ligj, që as këta kolegët këtu deputetë, të cilët e mashtruan popullin, por as ata të cilët mashtruan popullin në veri të mos ndëshkohen, apo të mos ndiqen penalisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Gashi e ka fjalën.

ALBANA GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Për ta njoftuar opinionin publik për përmbajtjen e këtij ligji, më saktësisht për ata të cilët do të përfitojnë nga ky ligj, unë do t'i përmend disa shkelje konkrete, të cilat do të amnistohen nëpërmjet këtij ligji.

Më 3 dhe 4 shkurt të vitit 2000, 11 shqiptarë janë vrarë, 25 u plagosën me armë zjarri, 93 të tjerë janë keqtrajtuar ose lënduar, 1 564 familje së bashku me 11 364 anëtarë tjerë janë dëbuar nga shtëpitë e tyre dhe strukturat, të cilat i organizuan këto vrasje, plagosje e dëbime, do të amnistohen nëpërmjet këtij ligji.

Më 17 mars të vitit 2004, dy fëmijë shqiptarë në pjesën veriore të Mitrovicës u mbytën në lumin Ibër. Disa fëmijë të tjerë që mbijetuan në orët e vona të po asaj nate treguan se ata ishin ndjekur nga serbët dhe se ata ishin duke ikur, kur disa nga bashkatdhetarët e tyre u mbytën në lumë.

Më 18 shkurt të vitit 2008, një ditë pas shpalljes së pavarësisë, u dogjën pikat doganore 1 dhe 31 në Bërnjak nga një grup serbësh. Një muaj më vonë, u bë edhe hyrja e strukturave paralele në Gjykatën në veri të Mitrovicës, pra më 14 mars të vitit 2008.

Në korrik të vitit 2008, nga grupet kriminale serbe u pengua ndërtimi i ujësjellësit në Suhodoll. Më pastaj, vijon moslejimi i Ali Kadriut për ta rinovuar shtëpinë e tij, duke e shtënë edhe me automatikë. Kjo ka ndodhur pra në vitin 2008, si dhe pengimi i ndërtimit të shumë shtëpive tjera, që ka pasuar edhe në vitet tjera.

Për rrahjet dhe frikësimet e banorëve shqiptarë në Lagjen e Boshnjakëve, po ashtu do të amnistohen strukturat që i organizuan ato. Më pastaj janë edhe barrikadat dhe uzurpimi i ndërtesës së Komunës së Shtërpçës, në korrik të vitit 2008.

Inaugurimi dhe funksionimi i Postë-Telekomit të Serbisë në Graçanicë, më 22 dhjetor të vitit 2008, pengimi i Sheremet Ahmetit për t'i vizituar stacionet e Policisë, më 5 mars 2009. Të gjitha këto u realizuan nga këto struktura kriminale, të cilat do të amnistohen nëpërmjet këtij ligji.

Më pastaj e kemi edhe rastin e 25 korrikut të vitit 2011, kur gjatë një ndërhyrjeje të forcave speciale në veri të Kosovës për ta marrë kontrollin e pikave 1 dhe 31, nga strukturat kriminale e të paligjshme të Beogradit u vra pjesëtari i kësaj njësie, Enver Zymberi.

Në prill të vitit 2012, si rezultat i një sulmi me mjet eksplodues, në banesën e tij vritet Selver Haradinaj dhe plagosen fëmijët dhe gruaja e tij.

Më 19 prill të po këtij viti demolohet për herë të dytë pika statike në pikën kufitare 1, në Bërnjak. Këto vepra pra do të amnistohen.

Nëse miratohet ky projektligj, atëherë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës lirisht mund ta shpallin Kosovën si zonë të lirë të krimit.

Ky projektligj, përveç krimeve në veri, amnistion edhe krimet tjera, siç janë: veprimtaritë mjekësore ose farmaceutike, ku hapur vërehet se ka për qëllim ta amnistojë gjithë rrethin e mjekëve, politikanëve dhe kriminelëve e biznesmenëve të lidhur me PDK-në, të cilët ishin përfshirë në rastin “Medicus” për transplantimin e organeve.

Lirim nga ndjekja penale të shumë zyrtarëve e kryetarëve të komunave që vijnë nga radhët e PDK-së, asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, mashtrimi, kërcënimet e fyerjet, uzurpatorët e pronës publike, abuzuesit e posteve publike, korrupsioni etj., siç është rasti i Xhabir Zharkut dhe i shumë xhabirëve të tjerë, ndër to edhe ato të “Auto-Prishtinës”. Ky projektligj amnistion haraçin, reketizimin e shantazhin, falsifikuesit e dokumenteve, abuzuesit me votën e lirë dhe vjedhjet industriale të votave.

Ky ligj po ashtu e amnistion pengimin, si dhe sulmin ndaj personit zyrtar, si rasti i djemve Grabovci, të cilët e sulmojnë Policinë e Kosovës gjatë kryerjes së detyrës zyrtare dhe suspendohet polici, e jo djemtë e politikanëve të gjithëpushtetshëm.

Rastet e vrasjeve në aksidente trafiku, ku qartë vizatohet rasti i Bajrush Xhemajlit, i cili me çdo kusht tenton t’i ikë vuajtjes së dënimit, duke e ditur se me këtë ligj do t’i falet vrasja. Po, a do t’i falet vrasja nga familja e të ndjerit, lind pyetja këtu. Më pastaj të bëhet amnistimi i zyrtarëve të lartë publikë që janë pasuruar duke e dëmtuar ekonominë e Kosovës, duke amnistuar edhe pasuritë e atyre të paligjshme. Në këtë formë, edhe Ligji mbi konfiskimin e pasurisë të fituar në mënyrë të paligjshme do të mbetet pa objekt, ose pa fushëveprim të vetin. Projektligji për amnisti i liron nga ndjekja penale edhe të gjithë ata zyrtarë, politikanë e biznesmenë që janë pasuruar në 14 vjetët e fundit në kurriz të vendit.

Me këtë projektligj përfitojnë shumë biznesmenë, të cilët për vite të tëra u janë shmangur detyrimeve ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, me vlerë prej 212 milionë euro dhe të gjithë këta biznesmenë janë të afërt me pushtetin. Pra, ky është humanizmi, në të cilin thirret ministri Kuçi dhe bashkëpartiakët e tij. Kjo është padrejtësia, të cilën na e proklamoi kjo Qeveri. Krimi i organizuar në veri ishte dhe është në koordinim me biznesmenët dhe politikanët shqiptarë.

Për këtë arsye, strukturat paralele në veri veprojnë lirshëm për shkak se në njëfarë mënyre e kanë mbështetjen e politikanëve shqiptarë, të cilët i mbulojnë ata për të përfituar nga ata.

Dialogu për veriun është shpërblim për strukturat ilegale dhe armiqësore të Serbisë, për kriminelët dhe kriminelin atje. Duke filluar prej dëbimit masiv të shqiptarëve në shkurt të vitit 2000, e deri te vrasja e Enver Zymberit e Selver Haradinajt.

Amnistimi i krimit që nga krerët partiakë po cilësohet si interes i vendit, është vetëm interes i kriminelëve dhe assesit i qytetarëve, i institucioneve shtetërore, në përgjithësi.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Unë kisha propozuar ta lini historinë. Kur të doni bëjmë debat lidhur me veprat dhe çështjet. Por për ligjin, koncentrohuni te ligji, ju lutem! Nuk desha të ta ndal fjalën, por keni qenë krejt jashtë rendit të ditës. Zoti Kurti e ka fjalën.

**ALBIN KURTI:** Para një viti, lajmet dominoheshin nga premtimi qeveritar për përmbylljen e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës. Më 10 shtator të vitit 2012

trumbetohej sesi Kosova tash e ka pavarësinë e plotë dhe se u hoq mbikëqyrja ndërkombëtare.

Sot, jo vetëm që nuk kemi pavarësi të plotë, por u vërtetua plotësisht ajo që thoshim ne të “Vetëvendosjes”. Së pari, mbikëqyrja po hiqet për të filluar dialogu politik për veriun, me ç’rast Piter Fejt do të duhej të shkonte në dialog nëse nuk shkon nga Kosova, sepse ai ishte kreu i vërtetë i shtetit e i Qeverisë, e jo Jahjaga e Thaçi. Dhe, së dyti, tash e tutja mbikëqyrja joformale do të jetë edhe më e rëndë se ajo zyrtare.

Ndikimet ndërkombëtare për ratifikimin e marrëveshjes me Serbinë dhe për Projektligjin për amnisti janë edhe më të rënda se para 10 shtatorit të vitit 2012. Ashtu qysh zgjedhjet për këtë Kuvend nuk ishin të lira, edhe zgjedhjet në këtë Kuvend nuk janë të lira.

Në memorandumin shpjegues të këtij projektligji thuhet që “amnistia bëhet duke pasur parasysh rrezikshmërinë e ulët të personave të amnistohen”. Mirëpo, këtu e kemi një kundërthënie logjike. Rreziku ka të bëjë me qëllimin e synimin e kriminelëve, ndërsa këtu kriminelët amnistohen për nga pasoja, pra nëse kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore, ose vrasje.

Nëse dikush ka shkaktuar lëndime të lehta trupore, ose dëme të mëdha materiale, sikur ato nga zjarrvëniet, kjo nuk do të thotë që ai është i parrezikshëm, por që nuk ka qenë i suksesshëm në atë moment për fatin e mirë të atyre që u sulmuan. Ky projektligj pra shpreh kufizim vetëm te rastet që kanë rezultuar me lëndime të rënda trupore, ose vrasje. Ata që janë sulmuar për t’u vrarë, por kanë pësuar lëndime trupore të cilat nuk cilësohen të rënda, do të amnistohen.

Pra, marrëdhënia e këtillë e shtetit të Kosovës me kriminelët, jo vetëm në veri, është e organizuar rreth efikasitetit të kriminelëve, e jo vlerave të Republikës, e normave të drejtësisë.

Janë bërë edhe kërkesa që ky projektligj duhet të kufizohet vetëm në ato tri komuna e gjysmë në veri, mirëpo posa ta lexoni marrëveshjen 15-pikëshe Thaçi- Daçiq e kuptoni që kjo nuk është e mundur. Asociacioni i komunave me shumicë serbe nuk është vetëm i komunave në veri të Ibrit, por gjithandej nëpër Kosovë dhe struktura kriminale-armiqësore të Serbisë ka anekënd Kosovës, e jo vetëm në veri.

Prandaj, ky projektligj nuk është i kufizuar në territorin e komunave në veri, e natyrisht që këtu po i kontrabandojnë edhe krimet e xhabirëve për t’i amnistuar. Kjo qeveri është qeveri e kontrabandës. Ajo kontrabandon mall në treg e njerëz në politikë, ligje në Kuvend e marrëveshje me Serbinë në shtet.

Pardje, pra të martën, pas takimit me baroneshën Ashton në Beograd, kryetari i Serbisë, Nikoliq, pati një konferencë të përbashkët me të, e ku ishte edhe kryeministri i Serbisë, Daçiq. Aty Nikoliq deklaroi që për të kërkuar diçka nga Serbia, një herë duhet t’i jepet diçka asaj. Dhe, vetëm dy minuta më herët gjatë fjalës së tij, ai kishte thënë që bashkësia serbe do ta ketë policinë e vet, komandantin e vet rajonal, i cili do të jetë nën

juridiksionin e Prishtinës, aq sa është edhe komandanti i Rashkës nën juridiksionin e Prishtinës. Pra, brenda së njëjtës fjalë të tij 5-minutëshe, ai i thotë dy gjëra interesante.

Në njërën anë thotë që komandanti rajonal për veriun do të jetë nën juridiksionin e Prishtinës, aq sa është komandanti i Rashkës dhe, në anën tjetër, ai më pastaj thotë që nuk mund t'i kërkosht diçka Serbisë pa i dhënë një herë asaj. Afër tij ishte edhe kryeministri Daçiç, e këtyre të dyve po u beson kryeministri Thaçi, i cili po merret vesh me ta.

Amnistia e strukturave të Serbisë në veri po ndodh pa u bërë çarmatosja e demilitarizimi në veri të Kosovës. Mos harroni që në veri të Kosovës ka më shumë armatim se në krejt Kosovën. Nuk po ndodh një herë çarmatosja dhe demilitarizimi atje, e më pastaj amnistia, por po ndodh amnistia pa na kërkuar ata falje dhe pa u bërë fare çarmatosja dhe demilitarizimi i asaj zone që për 14 vjet me radhë ka qenë nën kontrollin e strukturave të Serbisë.

Duke i amnistuar krimet e Serbisë më parë sesa integrimin e veriut në Kosovë, do të kemi integrim të Kosovës në veri.

Pas takimit me baroneshën Eshton, në anën tjetër, Thaçi tha se kjo amnisti i afron e i pajton njerëzit. Kjo ka kuptim vetëm nëse konsiderohet që kriminelët serbë paskan pasur të drejtë të jenë të hidhëruar dhe tash pasi t'i falin, ata do të pranojnë të pajtohen me shqiptarët.

Me këtë qasje kryeministri Thaçi po e kriminalizon rezistencën ndaj Serbisë dhe luftën tonë çlirimtare. Thaçi po synon pajtim, mirëpo historia na dëshmon që kërkesa për pajtim është kërkesë e xhelatit, dhe jo e viktimës.

Në asnjë situatë, në asnjë kohë, nuk është viktimja ajo që kërkon të pajtohet me xhelatin. Është xhelati ai i cili kërkon të pajtohet me viktimen.

Thaçi po e merr rolin e xhelatit kur kërkon pajtim dhe këtë po e bën në emër të gjithë Kosovës.

Ky kryeministër ka qejf të na e përkujtojë vazhdimisht qysh NATO-ja na e paska shpëtuar Kosovën. Le ta marrim për të mirëqenë këtë përshtypje, pa rezervë, pra le të themi se NATO-ja na e paska shpëtuar Kosovën.

Mirëpo, sot NATO-ja nuk mund ta shpëtojë Kosovën. I vetmi njeri që mund ta shpëtojë Kosovën është kryeministri Thaçi. Vetëm kryeministri Thaçi mund të na e shpëtojë Kosovën.

Vetëm ai mund të bëjë diçka që nuk e bën dot as NATO-ja, as Bashkimi Evropian, e as Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Mirëpo, për këtë qëllim madhor, kryeministri Thaçi duhet ta bëjë një akt madhor - të shkojë në burg. Përdërisa ai është në liri Kosova vetëm sa do të fundoset. Kryeministri në burg, shpëton Kosova! Kryeministri në liri e në pushtet - fundoset Kosova!

Prandaj, unë i bëj thirrje kryeministrit Thaçi të shkojë e të dorëzohet te EULEX-i, të cilin vetë e ka ftuar, ose edhe më mirë, le të shkojë te Prokuroria e Kosovës dhe të rrëfëhet aty gjerë e gjatë për të gjitha krimet e gjithë korrupsionin që e ka bërë.

Sulmet mbi Kosovën do të zmbarsen. Nuk do të jetë aspak e domosdoshme të bëjmë dialog me Serbinë pa kushte për Serbinë e për çështje të brendshme të Kosovës.

Ky kryeministër i korruptuar e i shantazhuar është edhe mundësia, edhe kushti i këtij dialogu makabër me Serbinë, që po na e bosnjëzon Kosovën.

Dëshmorët e patën sakrifikuar veten për Kosovën, ndërkaq Thaçi po e sakrifikon Kosovën për veten e tij. Pra, Thaçi është anti-dëshmor.

Të këqijat kryesore në Kosovë ndodhin vetëm që Thaçi të mos shkojë në burg. Edhe privatizimet e egra, kur shiten ndërmarrjet më lirë se falas, edhe koncesionet e panumërta ndaj Serbisë, të gjitha këto bëhen vetëm e vetëm që Thaçi të mos shkojë në burg.

Edhe gjahu e persekutimi ndaj ish-pjesëtarëve të UÇK-së ndodh pikërisht pse ky kryeministër nuk merr përgjegjësi. Nuk ka burg në Kosovë që s'ka pjesëtarë të shumë të UÇK-së.

Në Burgun e Hagës, nganjëherë kishte më shumë shqiptarë se serbë, gjithnjë për shkak se ky kryeministër do pushtet lart, pa përgjegjësi poshtë.

Në një intervistë me gazetaren Jeta Xharra, para disa viteve, kur ajo iu drejtua kryeministrit me nofkën “Komandant Gjarpri”, ky tha: “jo s’kam qenë komandant, jam marrë me politikë si drejtor i Drejtorisë Politike”. Po e kuptoni pra që qerulli vicioz në Kosovë është ai i kryeministrit mizor ndaj qytetarëve dhe servil ndaj ndërkombëtarëve, i cili anash e ekspozon UÇK-në ndaj EULEX-it. Kjo është ajo pra që po e tjetërson edhe të kaluarën e Kosovës, e lëre më që po na e errëson të ardhmen.

Në të njëjtën kohë, duhet ta keni parasysh se qëndrimi që duhet të votohet ky Projektligj për amnisti, për shkak se kjo parashihet në planin e zbatimit, nuk është i qëndrueshëm. Plani i zbatimit nuk është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Plani i zbatimit është miratuar vetëm në Qeverinë e Kosovës. Ka kuptim kur ndonjë qeveritar thotë: “Miratojeni Projektligjin për amnisti për shkak se e kemi kaluar në Qeveri”. Mirëpo, deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe aq më pak deputetët opozitarë nuk do të duhej kurrësesi të thonë që ne po e miratojmë këtë projektligj për shkak se është në planin e zbatimit. Plani i zbatimit është plani i zbatimit të Thaçit, jo i yni.

Sot, në këtë Kuvend nuk ka demokraci. Fakti që kemi ardhur në situatën kur duhet të votojmë për ose kundër këtij projektligji kriminal tregon se sa poshtë ka rënë Kosova dhe

dëshmon që këtu nuk ka demokraci. Prandaj, sot, asnjëri deputet nuk i përfaqëson as qytetarët, e as votuesit. Asnjëri prej jush nuk ka folur në fushatë, e nuk e ka program një kesi projektligji.

Këtu kemi vetëm dy lloj deputetësh sot, varësisht se si do të votojnë: deputetët e krimit dhe deputetët kundër krimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

U tha që tash, pas ndryshimeve nga hera e parë, respektivisht me heqjen e nenit 3, që ishte në projektligjin e kaluar, ligji ka karakter të plotë dhe të qartë politik dhe i tërë arsyetimi po ndërlidhet me elementin me atë që ky projektligj është projektligj politik dhe ne si Grup Parlamentar, unë si deputet, pajtohem plotësisht që ky projektligj është projektligj tipik politik dhe kjo amnisti i bie të jetë politike.

Nëse e shohim për nga përmbajtja, natyrisht që ajo nuk duket të jetë politike, sepse tërë veprat që amnistohen janë vepra kriminale, e kur të thuhet amnisti politike nënkuptohen veprimtarët politikë.

E në këtë projektligj, kur të fillosh t'i shikosh rend veprat, janë kryesisht vepra që kanë të bëjnë me krimin, e jo me veprimtarinë politike.

Pozita e quan politike, sepse natyrisht edhe politika e Qeverisë sot është e natyrës kriminale, njëjtë sikur ky projektligj.

Pra, ky projektligj është fytyra, është pasqyra e politikës së Qeverisë dhe njëkohësisht është fytyra dhe pasqyra e marrëveshjes së ratifikuar. Dhe, ne, duke e pasur të qartë këtë politikë, e kemi të qartë që edhe ky projektligj është burim dhe derivat i kësaj politike. Prandaj, është ndikimi politik ai i cili e ka sjellë këtë projektligj.

Kur të fillojmë t'i shikojmë vetë veprat, e shohim që kemi të bëjmë me vepra të ndryshme, të cilat nuk kanë fare të bëjnë me veprimtarinë politike.

U përmend nga deputetja Trajković, që ka pasur edhe amnisti për shqiptarët në Serbi më herët, e ka pasur edhe amnisti për shqiptarët në Maqedoni. Kudo që ka pasur ndonjë amnisti për shqiptarët, të mos harrojmë që të gjitha kanë pas të bëjnë me veprimtari të qarta politike, ndërsa këtu amnistohet ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore dhe farmaceutike.

Kemi kontrabandë të mallrave, shmangie nga pagesat e tarifave të detyrueshme doganore, ikje nga tatimi, shmangie mashtrore nga taksa importi dhe akciza. Të gjitha këto nuk kanë të bëjnë aspak me ndonjë veprimtari politike dhe krejt këto përpiqen të amnistohen, duke u quajtur se gjoja po amnistohen nëse ato janë bërë në funksion të veprës penale - thirrja për rezistencë.

Kjo çështja e thirrjes për rezistencë, e cila është futur te neni 1.1.15, është kamuflimi i dytë që i bëhet këtij projektligji.

Pra, me këtë projektligj, të gjitha këto vepra kriminale që u përmendën nuk kanë të bëjnë, në fund të fundit, nuk mbetet të bëjnë, natyrisht që i përfshijnë strukturat e veriut, i këputin çdo rrugë, veç amnistohen veprat që i kanë bërë ato, e këputin rrugën edhe drejt hetimit të tyre.

Dhe, në fund, ato në përgjithësi amnistohen, sepse u shkëputen mundësitë e hetimit kundër tyre, por e njëjta gjë përcillet dhe shfrytëzohet edhe në pjesën këndeje lumit Ibër.

Këtu thuhet ‘thirrja për rezistencë’. Dhe, në emër të thirrjes për rezistencë paskan për t’u amnistuar qytetarët nëse i kanë kryer këto vepra.

Po e zëmë, po dalim në pjesën veriore. Atje ka pasur thirrje për rezistencë nga strukturat serbe. Po presupozoj që e tëra është menduar te thirrja për rezistencë nga strukturat paralele të Serbisë. Ka pasur thirrje për rezistencë nga strukturat paralele të Serbisë dhe këtu amnistohen personat, të cilët, qofshin apo jo pjesë e strukturave, kanë bërë shkelje që kanë të bëjnë, për shembull, siç është çështja e veprimeve me kontrabandë, e kështu me radhë.

Dhe, tash, nëse i ka ikur tatimit, apo ka bërë kontrabandë një serb në veri dhe një shqiptar tjetër në veri, këtu, sipas këtij projektligji, ata amnistohen që të dy, sepse, e para, nuk ka ndarje në vija etnike dhe, e dyta, nuk specifikohet që nga ai që e ka shkelur ligjin të kërkohej deklarim se e ka bërë këtë në emër të thirrjes për rezistencë.

Njëjtë mund ta shikojmë situatën, ta bartim në Graçanicë. Edhe aty ka pasur struktura paralele, edhe aty ka pasur thirrje për rezistencë. Të njëjtin gjë mund ta bartin edhe në Prishtinë. Edhe në Prishtinë ka qytetarë serbë për të cilët ka vlejtur thirrja për rezistencë. Dhe, kur nuk i specifikon këto, a i bie kjo që të gjithë këta veprimtarë krimi, të ashtuquajtur politikë, të cilët kanë bërë kontrabandë dhe u janë shmangur tatimeve dhe ndiqen penalisht për shkak të ikjes së tatimit në mënyrë automatike në gjithë Kosovën do të amnistohen? Pra, pse atëherë e vutë thirrjen për rezistencë vetëm sa për ta kamufluar komplet edhe amnistinë për shumë kriminelë në pjesën jugore këndeje lumit Ibër?

Dhe, në fund të fundit, si mund ta quani veprim politik apo drejt normalizimit, kur edhe ato struktura që janë në veri, e të cilat po amnistohen, po amnistohen veprat e tyre, e kjo po ndodh pa ndodhur së paku kthimi i qytetarëve shqiptarë nga pjesa veriore.

Ata janë dëbuar dhe nuk po kthehen prapë. Nuk ka kushte për ta që nuk kthehen, në ndërkohë që ata që i kanë dëbuar ata po amnistohen me këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!  
Të nderuar deputetë,



Dhe qytetarë të Kosovës,

Lëvizja “Vetëvendosje” konsideron se me këtë projektligj në këtë formë çfarë ka ardhur në Kuvend nuk synohet të bëhet integrimi i vërtetë i veriut, por në fakt të legalizohen strukturat kriminale përtej Ibrit e këndej Ibrit në territorin e Kosovës, sepse që të bëhet një integrim i vërtetë i veriut, ne konsiderojmë se duhet të ndërmarrë hapa të tjerë.

Prandaj, në funksion të alternativës sonë qeverisëse, disa nga kushtet e domosdoshme për t’u plotësuar me qëllim që të integrohet veriu e të bashkohet Mitrovica, janë: që në veri të ketë një prani të shtuar të policisë për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme atje, një bazë e Njesisë Speciale të Policisë së Kosovës të jetë e vendosur në Lagjen e Boshnjakëve, në ish-bazën e KFOR-it, përkatësisht ish-remontin ushtarak, dy baza të tjera të Njesisë Speciale, së bashku edhe me forca ushtarake të jenë në afërsi të pikave kufitare 1 dhe 31.

Duhet të ndërpriten përfundimisht dhe zyrtarisht bisedimet me Serbinë, të cilat, siç e dimë, janë bisedime pa kushte për Serbinë dhe për çështje të brendshme të Kosovës. Me këto bisedime nuk forcohet pavarësia e Kosovës prej Serbisë, por pavarësia e veriut të Kosovës prej Kosovës.

Duhet të vihen në shënjestër burimet financiare të strukturave ilegale dhe armiqësore të Serbisë, duhet gjurmuar dhe duhet prerë financimi i tyre nga Serbia dhe nga krimi i organizuar e bizneset informale.

Nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme pa reciprocitet e simetri të të drejtave të serbëve në Kosovë me shqiptarët në Serbi.

Shqipëria dhe Kosova bashkërisht duhet të angazhohen për shqiptarët kudo që ata janë, e posaçërisht për ata në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc.

Arsyeja kryesore pse Serbia e ka synuar decentralizimin e Anamoravës është që ta hedhë farën e ndarjes dhe izolimit të asaj pjese nga Kosova.

Qeveritë dhe kryeministrat e pasluftës janë munduar t’i integrojnë serbët duke u dhënë ose premtuar euro kesh, duke u falur traktorë, apo duke ua ruajtur pagat edhe kur ata punonin për Serbinë.

Zgjidhja është krejtësisht ndryshe: Jo para e privilegje, por zhvillim arsimor e ekonomik dhe barazi para ligjit. Jo bisedime me Serbinë, me strukturat e saj, por integritet territorial për vendin e sovranitetit për shtetin.

Rivitalizimi i “Trepçës”, funksionalizimi i saj, që do të rezultonte me punësimin e rreth 8 000 vetave, do të kontribuonte në bashkimin e qytetit, sepse ndarja në Ibër e kalon Minierën e Stari-Tërgut në njërën anën, ndërsa shkritoren në anën tjetër, në Zveçan.

Kështu, Mitrovica u shndërrua në qytetin më të varfër dhe ai është i vetmi qytet në Kosovë, të cilit i është zvogëluar popullsia gjatë viteve.

Ofrimi i bursave për shqiptarët dhe serbët nga veriu për në shkollat e mesme edhe në UP. Forcimi i fshatrave të shqiptarëve dhe lagjeve të Mitrovicës të banuara me shqiptarë në veri, duke u ofruar mjete për rindërtimin e shtëpive, infrastrukturë të mirë, transport publik falas për në jug të Mitrovicës dhe anasjelltas tri herë në ditë, lehtësim në punësim, lehtësim për regjistrim në universitet.

Vetëm më 3 dhe 4 shkurt të vitit 2000, 11 shqiptarë janë vrarë, me dhjetëra të tjerë janë keqtrajtuar ose lënduar, ndërsa 1 564 familje me 11 364 anëtarë janë dëbuar.

Secili shqiptar i dëbuar duhet të kërkojë të kthehet në pronën e vetë në veri dhe njëkohësisht të organizohen dhe mobilizohen për këtë. Ata që nuk duan duhet ta thonë hapur këtë dhe t'ua shesin të tjerëve pasurinë atyre që duan të kthehen atje.

Qeveria duhet ta ndihmojë dhe ta mbështesë këtë me një program të veçantë.

Nuk do të lejohet më që Qeveria e Serbisë t'i blejë pronat e shqiptarëve në veri. Të gjithë shqiptarët që janë të detyruar t'i shesin pronat e tyre, Qeveria e Kosovës duhet t'ua blejë ato.

Pra, vetëm me plotësimin e këtyre të kushteve të domosdoshme mund të bëhet integrimi i vërtetë i pjesës veriore, e jo me projektligje për amnisti të krimit, sepse me të vërtetë kjo do të thotë edhe më tepër forcim i krimit sesa zhdukje e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është zoti Ymeri. I lus kryetarët e grupeve parlamentare që t'i thërrasin deputetët.

VISAR YMERI: Nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,  
Deputetë,

Nuk kam si t'u ik pa iu referuar disa prej fjalëve që i dëgjova këtu nga deputetët e këtij Kuvendi sa i përket ligjit për shkak se natyrisht që kanë të bëjnë shumë edhe me temën, edhe me sjelljet e tyre në këtë Kuvend. Nuk po flas për këto ofendimet banale që i thonë disa prej rendit të parë të Grupit Parlamentar të PDK-së, këta njerëz që janë nën hetime, ose në gjykime për krime të ndryshme, por po flas në përgjithësi për fjalë publike që i thanë deputetët këtu.

Për shembull, u dëgjua njëra prej arsyetimeve, u tha që tash po fal Kosova. Edhe kjo u dashka të jetë një lloj rritje e dinjitetit pra për Kuvendin e republikës së Kosovës, sepse meqenëse Kosova e paska mundësinë të falë, ajo po u dashka të falë. Po të mos e harrojmë një gjë: ky ligj që ka ardhur këtu, Ligji për amnistinë, së bashku me këtë pjesën e cila është e panegocueshme në Kuvendin e Republikës së Kosovës, mos e harroni këtë, e ka thënë edhe zëvendëskryeministri në seancën e kaluar, është një pjesë e tekstit të ligjit që nuk negociohet për shkak se tash më është përfunduar negociimi për të me Daçiqin.

Ky ligj është kërkesë e Daçiqit, ky ligj është kërkesë e Serbisë. Po vërtet që po kërkohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ta votojë, por kërkesa vjen prej Serbisë, prej Qeverisë së Serbisë, dhe e kemi parë se sa i zhgënjyer u nda herën e kaluar Daçiqi me

Kuvendin e Republikës së Kosovës kur nuk i kaloj ligji. Pra, kjo po tregon qartë se kush e ka sjellë këtë ligj këtu. Dhe, dorën në zemër, Qeveria e Kosovës si logjistikë që po shërben, nuk duhet të na ngazëllezë që paskemi qeveri. Kjo është logjistikë për Qeverinë e Serbisë. Këtë rol po e kryen karshi këtij ligji.

Një çështje tjetër, sigurisht e keni dëgjuar, edhe pse është lajm i ri, që Qeveria e Kroacisë, menjëherë pas hyrjes, kur edhe formalisht, edhe zyrtarisht u bë pjesë e Bashkimit Evropian, si shteti i 28-të, ia ka dorëzuar një listë të përditësuar Qeverisë në Beograd, ku i ka renditur 1 557 persona, të cilët Qeveria e Kroacisë i konsideron kriminelë të luftës për krimet që janë kryer në Kroaci. Pra, kjo listë i është dorëzuar, mbase javën e kaluar, apo këtë javë, nuk e di, por lajmi ka qarkulluar dje. Dhe, këtë listë e ka pranuar Qeveria e Serbisë.

Çka do të thotë kjo? Kjo na tregon se në fakt paqja e vërtetë ndërmjet dy shteteve të barabarta është ajo paqe, e cila arrihet në mënyrën siç po e arrin Kroacia me Serbinë. Pra, paqja e vërtetë është ajo që Kroacia e ka me Serbinë, e jo ajo që Bosnja dhe Kosova po e bëjnë me Serbinë.

Serbia i ka normalizuar marrëdhëniet me Kroacinë shumë më tepër sesa me Bosnjën dhe Kosovën, dhe kjo është shumë e qartë. Normalizimi pa drejtësi është abnormalizim. Nuk është normalizim.

Jo duke e amnistuar Serbinë, siç po tenton të bëjë Qeveria e Kosovës tash nëpërmjet këtij Kuvendi, por duke e akuzuar dhe fajësuar atë, ashtu bëhet normalizimi me Serbinë.

Me amnistinë e krimeve të Serbisë, të kryera në Kosovë, ne kurrë më nuk mund të ndërmarrin masa që këto krime të sillen para drejtësisë. Pra, ne po ia lidhim këmbët vetes në mënyrë që ta mbajnë Serbinë fajtores, përgjegjëse për krimet që i ka kryer në Kosovë.

Unë nuk po e kuptoj pse kjo nguti dhe pse ky zell i kësaj Qeverie dhe i disa deputetëve këtu që ta amnistojnë Serbinë.

Çështja tjetër, pse e ka bërë Kroacia këtë çështje, pra kur ka hyrë në BE, pse e ka përditësuar këtë listë? Sepse, tash si anëtar i BE-së, Kroacia ka mundësi që këto kërkesa dhe këtë listë të kriminelëve serbë, dhe kërkesën për t'i kthyer ata apo për t'i dënuar, ta bëjë kusht dhe kërkesë të Bashkimit Evropian karshi Serbisë. Pra, që do t'i vihet rrugës ose mbase do t'i vihet nëse e bën Kroacia, se nuk po them që e bën domosdoshmërisht, por që ka mundësi tash ta bëjë, që t'i vihet si pengesë Serbisë për të aderuar në Bashkimin Evropian.

Dhe, tash, paramendoni se si mund të na paraqitet ne kjo situatë në marrëdhëniet ndërmjet Kosovës edhe Bashkimit Evropian, ta zëmë, nëse Kosova si shtet i plotfuqishëm e sovran, do ta fillojë një rrugëtim drejt Bashkimit Evropian, duke e pasur parasysh që Serbia do të hyjë para Kosovës në Bashkimin Evropian dhe atë me ndihmën e Kosovës, atëherë shumë thjesht Serbia mund ta bëjë një listë të tillë karshi Kosovës.

Pra, Serbia ta paraqesë një kusht të ri për Kosovën karshi Bashkimit Evropian, duke kërkuar që Kosova t'i dorëzojë ata persona që Serbia i konsideron si kriminelë luftime. Siç po bën tash nëpërmjet EULEX-it që po kërkon t'i arrestojë ushtarët dhe komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nesër kjo kërkesë do të bëhet edhe më e fuqishme, sepse do të vijë nga Bashkimi Evropian. Edhe ky është rishkrim i historisë, apo jo?

Pra, ne po ia mundësojmë Serbisë që ajo ta rishkruajë historinë dhe historikun kriminal të saj në Kosovë, duke na paraqitur ne si kriminelë, ndërkohë veten si viktimë. Pra, këtë po ia bëjmë edhe nëpërmjet këtij Ligji të amnistisë, të cilën ju po doni ta votoni sot në lexim të parë, e mbase, nëse kërkon shmangieje të Rregullores, edhe në lexim të dytë.

Shumë gjëra u thanë këtu për ligjin, për nene të caktuara të tij, për vepra të caktuara që ky ligj i amnistion dhe nuk dua t'i shtoj asgjë asaj që u tha, por vetëm po dua t'i ngre edhe disa çështje që kanë të bëjnë edhe me ligjin, edhe me krejt këtë debat që e kemi pasur përreth kësaj.

U tha këtu nga deputetë që vetëm Lëvizja “Vetëvendosje” po e kundërshtuaka Ligjin për amnisti. Pra, siç na quajtën disa ‘revolucionarë të vetmuar’, e disa të tjerë na ofenduan me fjalë edhe më të rënda.

Po jua tërheq vërejtjen te disa kundërshtime tjera, të cilat vijnë edhe përbrenda Kosovës, edhe prej jashtë Kosovës. Pra, edhe prej shoqërisë civile, mbi 60 organizata të shoqërisë civile janë bërë bashkë për ta kundërshtuar këtë ligj.

Shumë prej përfaqësuesve të medieve, nëpërmjet medieve të tyre, e kanë kundërshtuar këtë ligj, edhe në formën e re, që na ka ardhur këtu.

Dhe, po ashtu komisionarja e lartë e OKB-së për të Drejtat e Njeriut, e cila e vizitoi Kosovën në fund të qershorit, ndërmjet tjerash, tha: “I kam ngrehur edhe disa çështje brengosëse për ne, pra për të, veçanërisht me planet e propozuara për miratimin e Ligjit për amnisti dhe rregullimin e Gjyqësorit sipas vijave etnike”. Kjo ishte një brengë që komisionarja më e lartë për të Drejtat e Njeriut, e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, e ka sjellë, kur e ka vizituar Prishtinën më 20 qershor të vitit 2013. Kjo nuk është e “Vetëvendosjes”, ju e dini apo jo, as nuk është e shoqërisë civile të Kosovës, është e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Tjetër? Në një intervistë, Avokati i Popullit, apo Ombudspersoni, siç po quhet nganjëherë këtu, të cilën ia kishte dhënë gazetës “Tribuna”, menjëherë pas dështimit të miratimit të ligjit javën e kaluar, tha që ky ligj po të miratohej, po fliste për ditën kur është diskutuar për herë të parë, do ta dëmtonte shumë, madje edhe do ta prapakhente rendin juridik dhe rendin kushtetues të Republikës së Kosovës. Pra, edhe Ombudspersoni është i zgjedhur nga ky Kuvend, e nuk është i “Vetëvendosjes”, apo jo? Pra, nuk qenka vetëm “Vetëvendosja” që po e kundërshton këtë.

Çështje tjetër? Në seancën e kaluar, ne e pamë që një numër i konsiderueshëm i deputetëve, fatmirësisht, sa për ta mos e lejuar kalimin e ligjit, votuan kundër tij, ose e

kundërshtuan atë duke mos votuar fare, ose duke abstenuar. Pra, këta deputetë nuk janë të “Vetëvendosjes”, apo jo. Janë të grupeve tuaja parlamentare. Edhe sot dëgjuam që ka deputetë që ende nuk u është mbushur mendja për këtë ligj se si po sillet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Dhe, me këtë nuk dua të them që të gjithë këta mendojnë si “Vetëvendosja”, sepse nuk mendojnë si “Vetëvendosja”. Arsyet e kundërshtimit të ligjit i kemi të ndryshme, edhe qëllimet e kundërshtimit të ligjit mbase i kemi të ndryshme.

Mirëpo, një gjë është shumë e qartë, që deputetët këtu, edhe ata që po thonë që do ta miratojmë ligjin dhe pastaj po e marrin mundin dhe po dërsiten të na tregojnë se si ligji është i mirë për t’u miratuar, dorën në zemër, nuk po e thonë vetëm një të vërtetë që e dimë të gjithë. Pra, është sekret publik tashmë pse po miratohet ky ligj. Sepse, po e kërkojnë të tjerët. Dhe mendoj që këta apo apologjetët që po flasin për të mirat e ligjit, të na e kursejnë edhe kohën edhe nervat nga këto shfajësime të ligjit, edhe të votës së tyre. Tregoni shumë qartë ‘na kanë thënë të tjerët, nuk po guxojmë t’u themi jo për arsye të ndryshme’, prapë nuk po ju gjykoj, e mos na tregoni se ligji është i mirë, sepse vetëm po dukeni qesharakë.

Më 22 prill, kur u aprovua Rezoluta për marrëveshjen, ishin 89 vota për. Apo jo? Ju kujtohet të gjithëve.

Më 27 qershor, kur u ratifikua marrëveshja, ishin 5 vota më pak, pra vetëm 84 e miratuan apo e pranuan ratifikimin e asaj marrëveshjeje.

Më 4 korrik, kur erdhi Projektligji për amnistinë ishin 14 më pak, pra vetëm 70. Është koha tash që të jenë edhe më pak. Pra, le të bëhemi bashkë kundër amnistisë së krimit, që të mos i kenë as 60 vota.

Është shumë e qartë se këtu është një situatë shumë e tendosur, natyrisht po shihet edhe në shoqëri. Pra, i kemi mijëra profesorë të Universitetit të Prishtinës që po heshtin, mijëra ish-luftëtarë të UÇK-së që po heshtin, mijëra ish të burgosur politikë që po heshtin. Kështu s’ka qenë, jo vetëm në kohën e Milosheviqit, por as në kohën e Rankoviqit nuk ka qenë situata e tillë. Kjo heshtje pra është heshtje para stuhisë, sepse, siç thotë populli shumë mirë, zullumi këputet prej trashi. E zullumin jeni kah e trashni shumë, e ai natyrisht se do të këputet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Zonja deputete,

Për miratimin e këtij projektligji kërkohen votat e 2/3 të të gjithë deputetëve të Kuvendit, neni 65, paragrafi 1, pika 15 e Kushtetutës, amendamenti 23. Pra, kërkohet minimumi prej 80 votave.

Para se të votojmë për projektligjin, lus deputetët që të votojnë për praninë. Votojmë tash! Faleminderit!

Me elektronikë 109 të pranishëm, prania fizike 112 deputetë.

Tani votojmë për miratimin në parim të Projektligjit për amnistinë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 91 vota për, 17 kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për amnistinë.

Ngarkohet Komisioni për Legjislacion dhe komisionet e përhershme që në afatin sa më të shpejtë të mundshëm ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Seanca e radhës është në orën 15:00. Mirupafshim!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*